

REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
QENDRA PER SHERBIM TE QYTETARIT  
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 25275  
U. Br.

Nr. i faq. 119 Data: 3/107  
Br. str. Datum:  
KAMENICE/A 2023

# STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PER KOMUNEN E KAMENICES 2023-2027



KORRIK, 2023

# PËRMBAJTJA

---

LISTA E TABELAVE .....	4
LISTA E TABELAVE .....	6
LISTA E GRAFIKËVE.....	7
FJALA E KRYETARIT .....	9
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....	10
HYRJE.....	12
1.METODOLOGJIA .....	13
MISIONI .....	14
VIZIONI.....	15
2.ANALIZA E GJENDJES AKTUALE DHE SFIDAT KRYESORE.....	16
POZITA GJEOGRAFIKE.....	16
DEMOGRAFIA .....	17
POPULLSIA .....	19
STRUKTURA E MOSHËS, MIGRIMI.....	23
STRUKTURA ETNIKE DHE RELIGJIONI .....	24
ADMINISTRATA .....	26
ARSIMI.....	31
SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE.....	35
SHËRBBIMET SOCIALE REZIDENCIALE .....	39
INFRASTRUKTURA-UJËSJELLËSI .....	40
INFRASTRUKTURA TEKNIKE-FURNIZIMI ME UJË .....	42
INFRASTRUKTURA E KANALIZIMIT .....	45
RRUGËT DHE TRANSPORTI .....	46
NDRIÇIMI PUBLIK .....	49
QASJA NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT .....	50
KULTURË, RINI, SPORT-SEKTORI I KULTURËS .....	51
SEKTORI I SPORTIT.....	52
SEKTORI I RINISË.....	53

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

BIBLIOTEKA E QYTETIT .....	58
ARKIVI HISTORIK .....	59
EKONOMIA .....	60
TË DHËNAT SEKTORIALE PËR BIZNESE .....	61
BUJQËSIA .....	68
CILËSIA E TOKËS, HUMBJET E PËRKOHËSHME TË TOKËS.....	69
SEKTORI I PRODHIMTARISË, SEKTORI I BLEGTORISË.....	70
SEKTORI I PERIMEKULTURËS.....	71
SEKTORI I PEMËTARISË.....	72
ZHVILLIMI RURAL-INFRASTRUKTURA RURALE .....	73
SEKTORI I PYLLTARISË.....	74
BUXHETI KOMUNAL .....	76
TË HYRAT VETANAKE.....	78
STRUKTURA E SHPENZIMEVE .....	79
SHPENZIMET KOMUNALE .....	80
3.ANALIZA SWOT.....	81
4.QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE.....	84-92
5.PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË.....	92-109
SHTOJCAT .....	110

## LISTA E SHKURTESAVE

---

<b>SZHEL</b>	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
<b>NMV</b>	Ndërmarjet e Vogla dhe të Mesme
<b>AKK</b>	Asociacioni i Komunave të Kosovës
<b>GIZ</b>	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>AZHR</b>	Agjensia për Zhvillim Rural-Lindje
<b>ASK</b>	Agjensia e Statistikave të Kosovës
<b>OJQ</b>	Organizata joqeveritare
<b>Ha</b>	Hektar
<b>m</b>	Meter
<b>t</b>	Ton
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>IAAP</b>	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional
<b>QKMF</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
<b>QMF</b>	Qendra e Mjekësisë Familjare
<b>AMF</b>	Ambulanca e Mjekësisë Familjare
<b>SHKK</b>	Shtëpia e Komunitetit Kamenicë
<b>KRU</b>	Kompania Regjionale e Ujësjetësimit
<b>EF</b>	Ekonomitë Familjare
<b>QKB</b>	Qendra Komunale e Biznesit
<b>ARBK</b>	Agjensia për Regjistrimin e Bizneseve e Kosovës
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>BE</b>	Bashkësia Evropiane
<b>KAB</b>	Korniza Afatmesme e Buxhetit
<b>PNIM</b>	Plani Ndërkomunal i Integruar i Mbeturinave
<b>GPKHPB</b>	Grupi Punues Komunal për Hartimin e Planit të Banimit

## Lista e Tabelave

---

Tabela 1. Struktura organizative e Komunës së Kamenicës .....	11
Tabela 2. Karakteristikat hapësinore të Komunës .....	17
Tabela2a. Karakteristikat hapësinore të Komunës .....	17
Tabela 3. Klasifikimi i vendbanimeve në Komunën e Kamenicës .....	21
Tabela 4. Karakteristikat demografike të komunës .....	22
Tabela 5. Popullsia sipas moshës .....	23
Tabela 6. Numri i banorëve sipas shteteve në të cilat migruan .....	23
Tabela 7. Popullsia sipas përkatësisë etnike .....	24
Tabela 8. Popullsia sipas përkatësisë gjinore .....	24
Tabela 9. Raporti i shërbimeve sipas departamenteve .....	27
Tabela 10. Numri i të punësuarëve në vitet 2011-2022 .....	28
Tabela 11. Struktura kualifikuese, etnike dhe gjinore në administratë .....	29
Tabela 12. Struktura kualifikuese, etnike dhe gjinore në arsim .....	29
Tabela 13. Struktura kualifikuese, etnike dhe gjinore në shëndetësi .....	30
Tabela 14. Numri i nxënësve sipas largësisë së udhëtimit në shkolla .....	33
Tabela 15. Shërbimet e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QKMF) .....	36
Tabela 16. Përfituesit nga skema sociale 2018-2021 .....	37
Tabela 17. Skema për familje me aftësi të kufizuara (0-18) .....	38
Tabela 18. Lokalitetet që menaxhohen nga KRU “Hidromorava” në sis.e ujit dhe kanalizimit ...	40
Tabela 19. Burimet e ujit të pijes .....	43
Tabela 20. Vendbanimet me sistemin e ujësjellsit nga “Hidromorava” .....	43
Tabela 21. Numri i banorëve që kanë qasje në ujësjellës .....	44
Tablea 22. Trendi i prodhimit të ujit në m <sup>2</sup> për vitet 2013-2022 .....	44
Tabela 23. Vendbanimet që kanë qasje në sistem të kanalizimit .....	45
Tabela 24. Hapësirat e gjelbërta publike .....	46
Tabela 25 Numri i parkingjeve .....	46

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Tabela 26. Sasitë e grumbulluara në ton (t) .....	48
Tabela 27. Shtrirja e ndriçimit publik.....	49
Tabela 28. Lista e trashëgimisë kulturore .....	55-57
Tabela 29. Resurset minerale në Komunë .....	60
Tabela 30. Raporti i bizneseve të regjistruara dhe aktive .....	61
Tabela 31. Raporti i bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektorëve 2000-2018 .....	61
Tabela 32. Raporti i bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektorëve 2000-2022 .....	63
Tabela 33. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimt 2000-2018.....	64
Tabela 34. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimt 2000-2022.....	65
Tabela 35. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë.....2000-2018.....	65
Tabela 36. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë.....2000-2022 .....	66
Tabela 37. Krahasimi i bizneseve të regjisitruara dhe të shuara në vitet 2020-2021 .....	67
Tabela 38. Sipërfaqet bujqësore.....	68
Tabela 39. Humbjet e tokës .....	69
Tabela 40. Llojet e drithërave .....	70
Tabela 41. Kultivimi i llojeve të kafshëve .....	70
Tabela 42. Kultivimi i perimeve .....	71
Tabela 43. Sipërfaqet e mbjellura me pemë .....	72
Tabela 44. Sipërfaqet e mbjellura me pyje sipas pronësisë .....	74
Tabela 45. Sipërfaqet e mbjellura me pyje .....	74
Tabela 46. Burimet e financimit(€) në Komunën e Kamenicës 2022-2025 .....	76
Tabela 47. Plani afatmesëm i të hyrave totale në Komunë 2021-2024 .....	78
Tabela 48. Struktura e shpenzimeve në Komunë (€) në vitin 2022.....	79

## LISTA E GRAFIKËVE

---

Grafiku 1. Metodologjia .....	7
Grafiku 2. Popullsia e Komunës së Kamenicës sipas regjistrimeve të vitit 1948-2011.....	19
Grafiku 3. Vendbanimet sipas madhësisë demografike .....	20
Grafiku 4. Struktura e banimit .....	22
Grafiku 5. Struktura gjinore .....	22
Grafiku 6. Struktura sipas moshës .....	23
Grafiku 7. Popullsia sipas përkatësisë etnike.....	24
Grafiku 8. Popullsia sipas përkatësisë religjioze .....	25
Grafiku 9. Numri i të punësuarve 2014-2022 .....	28
Grafiku 10. Struktura kualifikuese në institucionet arsimore.....	32
Grafiku 11. Përfituesit nga skema sociale 2018-2021 .....	38
Grafiku 12. Qasja në sistemin e ujësjellësit .....	41
Grafiku 13. Qasja në sistemin e kanalizimit.....	41
Grafiku 14. Qasja në sistemin e mbeturinave .....	47
Grafiku 15. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektorëve 2000-2018 .....	62
Grafiku 16. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektorëve 2000-2022 .....	64
Grafiku 17. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimt.....2000-2018.....	64
Grafiku 18. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimt.....2000-2022.....	65
Grafiku 19. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë .....	65
Grafiku 20. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë .....	67
Grafiku 21. Sipërfaqet me pyje .....	74
Grafiku 22. Struktura e shpenzimeve .....	80

## Lista e anëtarëve për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Pozita
1	Selami Zylfiu	Drejtoria për Financa dhe Buxhet	Kryesues i Grupit për SZHEL
2	Ramush Ismajli	Drejtoria- Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	Zv.Kryesues i grupit
3	Finsik Kastrati	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	Anëtar
4	Burbuqe Leka	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë	Anëtare
5	Hysen Jerliu	Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat	Anëtar
6	Petrit Matoshi	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Anëtar
7	Durim Biqkaj	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Anëtar
8	Bektesh Dërmaku	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Anëtar
9	Mehmet Thaçi	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinor	Anëtar
10	Shefik Rudhani	Drejtoria Komunale e Arsimit	Anëtar
11	Florentina Kryeziu	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	Anëtare
12	Avni Hoda	Zyra e Kryetarit	Anëtar
13	Qëndresa Kastrati	Drejtoria për Zhvill. Ekonomik dhe Diasporë	Anëtare
14	Enver Mavriqi	Enti për Punësim	Anëtar
15	Lidiona Marovca	Zyra e Informimit	Anëtare
16	Selami Klaiqi	Universiteti "KADRI ZEKA"	Konsulent i jashtëm
17	Sadri Rrmoku	KLGI	Konsulent i jashtëm
18	Ardian Emini	Universiteti "KADRI ZEKA"	Konsulent I jashtëm
19	Esat Islami	Asociacioni i Komunave të Kosovës	Ekspert i jashtëm



## Fjala Hyrëse e Kryetarit të Komunës



Të dashur qytetarë të Kamenicës, si Kryetar i Komunës do të synoj të ndërtoj një ekonomi të qëndrueshme dhe të zhvilluar duke përqendruar përpjekjet tona në investime të mëtejshme në zhvillimin ekonomik lokal, avancimin e shërbimeve, përmirësimin e infrastrukturës publike, investime në politika arsimore për ngritje të cilësisë, avancimin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, zhvillimin bujqësor, përfshirë agro-turizmin dhe turizmin në veçanti, duke stimuluar zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, me qëllim të rritjes së të ardhurave dhe punësimit lokal duke krijuar një klimë të përshtatshme dhe të favorshme për investitorë të rinjë potencial.

Do të ndërtoj një kulturë bashkëpunimi dhe partneriteti, me qytetarët, bizneset, shoqatat dhe organizatat e tjera në komunën tonë. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e një ekipi të fortë dhe në ndarjen e përgjegjësisë për të arritur synimet e zhvillimit ekonomik lokal.

Do të jemi të kujdesshëm për të gjitha veprimet dhe vendimet që do të ndërmarrim, për t'u siguruar që ato të jenë të ligjshme, transparente, zhvillimore dhe do të jem llogaridhënës para qytetarëve. Kjo do të ndihmojë në rritjen e besimit të banorëve dhe bizneseve lokale si dhe në rritjen e mbështetjes për iniciativat reja.

Do të angazhohem për ndërtimin e një programi të qartë të komunikimit për të ndarë informacione, dhe për të dëgjuar nevojat dhe shqetësimet e komunitetit të ndërmarrësve. Kjo do të ndihmojë në përcaktimin e prioriteteteve të ndryshme të zhvillimit ekonomik lokal dhe në sigurimin e mbështetjes së plotë të komunitetit.

Si kryetar i komunës, do të kem një qëndrim të përkushtuar dhe të balancuar për mbështetjen e bizneseve lokale, në veçanti për vajzat dhe gratë si dhe për të rinjtë në fushën e teknologjisë informative, duke u siguruar që ata të kenë mundësinë të zhvillohen dhe të rriten në një mjedis të favorshëm. Do të angazhohemi të ofrojmë pako stimuluese në fushën e rritjes së kapaciteteve fizike si dhe ato profesionale, përmes trajnimeve në burime njerëzore për bizneset e vogla dhe të mesme, duke ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e tyre si dhe në rritjen e punësimit lokal.

I Juaji Kadri Rahimaj, Kryetar

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal, ka për synim që të nxjerr dhe ofrojë informacione relevante për publikun dhe gjithë akterët me interes, duke analizuar gjendjen aktuale në komunë, për të paraqitur një pasqyrë më të qartë mbi potencialin e zhvillimit dhe për të identifikuar sifdat dhe parandaluar trendet negative që mund të ndikojnë në zhvillim të gjithëmbarshëm. Kjo strategji është harutar për të ofruar objektiva dhe alternativa të reja drejt zhvillimit ekonomik lokal të qëndrueshëm për pesë vitet e ardhshme në komunë, për të shfrytëzuar dhe mobilizuar resurset njerëzore, natyrore dhe financiare, drejt vizionit dhe objektivave të përbashkëta.

Është një proces që bashkon partnerë të ndryshëm në zonën lokale, për të shfrytëzuar burimet ekonomike, duke ndihmuar në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e standardit jetësor dhe me synimin për uljen e papunësisë dhe zhdukjen e varfërisë, duke intervenuar në shumë fusha, si:

**Spektori i Arsimit:** Avancimi dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit

**Spektori i Infrastrukturës:** Përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve


**Spektori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:** Ruajtja e shëndetit të banorëve

**Spektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:** Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit

**Spektori i Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore:** Përmirësimi i infrastrukturës të turizmit dhe rekreacionit

## Struktura organizative e Komunës së Kamenicës

Tabela .1 Struktura e organizative e Komunës së Kamenicës



## H Y R J E

Çështjet e zhvillimeve makro-ekonomike ofrojnë mundësi, por njëkohësisht edhe sfida veçanërisht për komunat e vogla dhe të varfëra siç është Komuna e Kamenicës, sfidë sidomos është decentralizimi i tregut dhe globalizimi i tij.

Qeverisjet në komunë duhet të jenë në dijeni për ndikimet e tyre direkte ose indirekte, në mënyrë që të marin masa për neutralizimin e këtyre efekteve negative në ekonominë lokale dhe të hartojnë politika dhe strategji për eliminimin e ndikimit të tyre në zhvillimin ekonomik lokal dhe të arrijnë efekte sa më të shpejta sepse tashmë, dihet botërisht për ndikimin edhe të pandemisë COVID-19, dhe të luftës në Ukrainë.

Orientimi sa i përket ekonomisë duhet të jetë në zhvillimin e NVM-ve ekzistuese ose në krijimin e NVM-ve të reja, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të ardhurave, që do të ndikonte në zvogëlimin e varfërisë dhe përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve.

Kjo strategji është hartuar bazuar në dokumentin udhëzues: “Strategjia për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2019-2023”, të nxjerrur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e po ashtu edhe në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040.

Në kuadër të hartimit të strategjisë janë paraparë 5 objektiva, ku synohet fuqizimi i rolit të komunës në nxitjen e Zhvillimit Ekonomik Lokal, duke marrë për bazë edhe dokumentet tjera si:

- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2007-2010,
  - Draft Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023,
  - Planin Zhvillimor Urban 2013-2018,
  - Plani për Eficiencë të Energjisë 2016-2020, si dhe në
  - Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025,
- të cilat janë dokumentet kryesore strategjike ku komuna do të bazohet në përcaktimin e objektivave dhe vendimmarrjen për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të saj.

Fokusi i strategjisë duhet të jetë rritja e potencialit të të ardhurave, eliminimi i pikave të dobëta, rritja e kapitalit njerëzor për qeverisje efikase, arsim cilësor, infrastrukturë dhe mjedis i pastër, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, ambient të përshtatshëm për zvvillim të biznesit, bujqësi dhe turizëm të zhvilluar. E gjithë kjo synon ngritjen e cilësisë së jetesës në Komunën e Kamenicës për një periudhë pesë-vjeçare.

# 1.METODOLOGJIA


Ashtu siç parashihet me udhëzuesin për hartimin e dokumenteve strategjike, në fazën e parë është formuar Grupi Punues me anëtarë dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë komunale, dhe përfshirja e tyre në proces të hartimit të strategjisë. U potencua edhe më lartë se hartimi i strategjisë është bërë duke u bazuar në dokumentet bazike strategjike të komunës, gjithashtu duke analizuar gjendjen aktuale nga informatat e drejtorëve dhe antarëve të Grupit Punues për strategji, kontributet e marra gjatë takimit publik të mbajtur në fillim të hartimit të strategjisë e po ashtu nga komentet dhe sygjerimet e marra nga palët e interesit gjatë hartimit të strategjisë. Informata lidhur me qasjen e grupit punues për komentet e marra nga takimet e ndryshme, përfshirja e sygjerimeve dhe kërkesave të qytetarëve dhe bizneseve.

Përveç takimeve të rregullta të grupit punues, ka pasur një bashkëpunim me AKK, me përfaqësues të GIZ, AZHR –Lindje, me konsulentë dhe ekspertë të jashtëm, ku nga takimet dhe punëtoritë të cilat janë zhvilluar kanë rezultuar sugjerime, rekomandime dhe informata mjaft të rëndësishme për ta kompletuar dhe finalizuar draftin fillestar.

Më pastaj është përcaktuar misioni dhe vizioni i komunës si dhe janë përcaktuar objektivat, aktivitetet dhe qëllimet, poashtu është bërë një plan veprimi për të monitoruar dhe vlerësuar strategjinë.

Pra, qëllim parësor i kësaj strategjie është modelimi i kapacitetit ekonomik të Komunës së Kamenicës, për të përmirësuar të ardhmen e saj ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë, rrjedhimisht të identifikojë resurset që ka në dispozicion Komuna e Kamenicës, dhe shfrytëzimi i tyre për rritje ekonomike sa më të madhe.

**Gafiku.1 Metodologjia**



## **MISIONI**

*Të zhvillojmë ekonominë lokale në mënyrë të balancuar, duke rritur cilësinë e jetës për të gjithë banorët e komunës sonë, duke ofruar shërbime efikase dhe efektive. Ta njohim rolin kyç që kanë të rinjtë në fushën e teknologjisë informative, dhe ta vëmë në funksion të zhvillimit ekonomik lokal. Të kujdesemi për natyrën dhe resurset natyrore, duke shtuar kapacitetet me potencial turistik për turizmin rural.*


---

## VIZIONI

---

*Komuna e Kamenicës – thesar natyre,  
vend i mirëqenies dhe i balancimit  
shoqëror, mjedisor dhe ekonomik*

---



## 2. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE DHE SFIDAT KRYESORE

Kjo pjesë është një përshkrim dhe prezentim me informata bazike mbi gjendjen aktuale demografike, sociale dhe ekonomike të Komunës së Kamenicës. Respektivisht janë të dhëna dhe informata mbi pozitën dhe veçoritë gjeografike të komunës, popullsinë, migrimin, infrastrukturën, kulturën, bujqësinë,

arsimin dhe shëndetësinë, pozitën financiare të komunës, respektivisht buxhetin komunal dhe vazhdon me profilin ekonomik të komunës.

### Analiza e gjendjes aktuale

**Pozita gjeografike** - Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës. Pozita gjeografike e Komunës së Kamenicës është periferike në skajin më lindor të Kosovës, por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore kryesisht të banuara me shqiptarë. Komuna e Kamenicës shtrihet në regjionin e Anamoravës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike sidomos për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit. Kamenica ka klimë të mesme kontinentale, me verëra të nxehta dhe dimra të ftohtë. Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës së Kamenicës në hektar në anën tekstuale është 41663 ha 23 ari 74m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e Komunës së Kamenicës në hektar në anën grafike është 41662 ha 81ari 71m<sup>2</sup>.

Nëpërmjet magjstrales Gjilan-Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi 27 km, ndërsa distanca e Kamenicës nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina, përmes Gjilanit është 71 km, ndërsa përmes Novobërdës 55 km, kurse nga Kryeqyteti i Maqedonisë, Shkupi është 108 km. Distanca rrugore Kamenicë-Tiranë është 306 km, kurse me portin e Durrësit është 318 km.

Stacioni më i afërt hekurudhor është në Ferizaj në distancë 60km dhe në Bujanoc në largësi 30km, aeroportet më të afërta janë ai i Prishtinës 74 km nga rruga e Novobërdës, ndërsa i Shkupit 130km.

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës dhe kufizohet në:

- Jug-Perëndim me Komunën e Ranillugut;
- Perëndim me Komunën Novobërdës;



- Veri-Perëndim me Prishtinën;
- Veri me Komunën e Medvegjës
- Lindje me Vrajën; dhe
- Lindje dhe Jug-Lindje me Bujanocin.

Territori i Komunës së Kamenicës është territor kodrinoro-malor me disa lugina rreth lumenjve me tokë aluviale shumë të përshtatshme për pemëtari dhe kultura tjera bujqësore. Këto lloje të tokave shtrihen në pellgun e lumenjve: Lumi i Kamenicës (ish Krivareka), Lumi i Hogoshtit dhe Lumi i Desivojces.

Shprehur në përqindje, territori i Komunës së Kamenicës është 60% kodrinoro-malor dhe 40% i rrafshët. Lartësia më e ulët mbidetare është 380m te “Dheu i Bardhë”, kurse ajo më e lartë është 1223m “Guri i Zi”.



**Demografia**-Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të vitit 2011<sup>2</sup> Komuna e Kamenicës aktualisht ka 58 vendbanime, ku jetojnë 36,085 banorë dhe mosha mesatare është 31.5 vite. Por, vlenë të theksohet se vlersimet e fundit për vitin 2021 nga kjo agjenci janë 27,948<sup>3</sup> banorë, ku shihet se ka një tendencë të rënies së numrit të banorve. Siç u theksua më lartë, bazuar në sipërfaqen e përgjithshme të Komunës së Kamenicës

në hektarë në anën tekstuale është 41663 ha 23 ari 74m<sup>2</sup> ndërsa, sipërfaqja e përgjithshme e Komunës së Kamenicës në hektarë në anën grafike është 41662 ha 81ari 71m<sup>2</sup>, dhe dendësia aktuale e banorëve është 86 banorë/km<sup>2</sup>.

**Tabela 2. Karakteristikat hapësinore të Komunës**

Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Numri i banorëve	Dendësia (ba/km <sup>2</sup> )	Lartësia mesatare mbidetare
<b>41.663 ha</b>	36,085	86	600m

**Tabela 2.a Karakteristikat hapësinore të Komunës**

Struktura e popullsisë sipas vendbanimeve në Kamenicë					
NR.	VENDBANIMI	POPULLSIA	NR.	VENDBANIMI	POPULLSIA
1	Berivojcë	1553	30	Leshtar	446
2	Bllatë	35	31	Lisockë	98
3	Boscë	86	32	Marocë	64
4	Bratilloç	29	33	Meshinë	25
5	Busovatë	804	34	Moçar	113
6	Dajkoc	378	35	Muçivërc	1520
7	Dazhnicë	80	36	Novosellë	311

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027


8	Desivojcë	177	37	Petroc	1257
9	Feriqevë	61	38	Polickë	217
10	Gmicë	85	39	Qarrakoc	60
11	Gogolloc	10	40	Rahovicë	42
12	Gragjenik	2	41	Rogaçicë	2668
13	Grizimë	461	42	Ruboc	386
14	Gjyrishec	58	43	Sedllar	22
15	Hajnoc	460	44	Strellicë	47
16	Hodonoc	2446	45	Strezoc	276
17	Hogosht	1705	46	Svircë	59
18	Kamenicë	7331	47	Shahiq	34
19	Karaçevë e Epërme	1413	48	Shipashnicë e Epërme	1261
20	Karaçevë e Poshtme	940	49	Shipashnicë e Poshtme	753
21	Kolloleq	181	50	Tërstenë	100
22	Kopernicë	1183	51	Topanicë	2061
23	Koretin	3476	52	Tugjec	130
24	Kostadincë	48	53	Vaganesh	10
25	Kranidell	131	54	Velegllavë e Epërme	73
26	Kremenatë I	7	55	Velegllavë e Poshtme	0
27	Kremenatë II	0	56	Vriqec	78
28	Krilevë	586	57	Zajçec	46
29	Lajçiqi	160	58	Zhujë	42

**GJITHSEJ BANORË KAMENICË 36085**

<sup>2</sup>Burimi: ASK DATA Popullsia në komunën e Kamenicës sipas regjistrimeve, periudha 2011, fq.29-30<sup>3</sup>Burimi;ASK DATA Vlersimi i popullsisë 2021, fq,12


**Popullsia** - Rezultatet e regjistrimeve të popullsisë në këtë komunë për periudhën 1948- 2011 janë paraqitur në grafikonin 1. Siç shihet në grafikun në vijim, që nga viti 1948 e deri më sot Komuna e Kamenicës ka pasur një rritje, po ashtu edhe rënje të popullsisë. Konkretisht prej vitit 1948 deri në vitin 2011, kemi pothuajse ndryshim të popullsisë si rezultat të shtimit natyror, migrimit apo edhe ndarjes administrative të Komunës së Ranillugut dhe Novobërdës nga Komuna e Kamenicës.

**Grafiku.2 Popullsia në komunën e Kamenicës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2011**



Burimi:ASK DATA Popullsia në komunën e Kamenicës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2011

Grafiku.3 Vendbanimet sipas madhsisë demografike



<sup>2</sup>Burimi: ASKDATA: Popullsia e komunës së Kamenicës sipas vendbanimit, 2011. Fq.29-30

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

**Tabela.3 Klasifikimi i vendbanimeve në Komunën e Kamenicë sipas kategorizimit të vendbanimeve**

DERI NË 500 BANORË			500-999 BANORË	1000-1999 BANORË	2000-4999 BANORË	MBI 5000 BANORË
Bllatë	Kranidell	Strelicë	Busovatë	Berivojcë	Hodonoc	Kamenicë
Boscë	Kremenatë I	Strezoc	Karaqeve e Ep.	Hogosht	Koretin	
Bratilloç	Kremenat II	Svircë	Krilevë	Karaqevë e ep.	Rogacicë	
Dajkoc	Lajçiq	Shahiq	Shipashnicë.e p.	Kopërnice	Topanicë	
Dazhnicë	Leshtar	Tërstenë		Muçivëc		
Desivojcë	Lisockë	Tugjec		Petroc		
Feriqevë	Marocë	Vaganesh		Shipashnic e p		
Gmicë	Meshinë	Velegll. E ep.				
Gogolloc	Moçar	Velegll. E po.				
Gregjenik	Novo Sellë	Vriqec				
Grizimë	Poliçkë	Zajqec				
Gjyrishec	Qarakoc	Zhujë				
Hajnoc	Rahovicë					
Kolloleq	Ruboc					
Kostadincë	Sedllarë					

Vendi i popullsisë së qendrës së komunës në raport me popullsinë e gjithëmbarshme në komunë është qyteti i Kamenicës, me 7331 banorë, ose shprehur në përqindje 20.31%, ku edhe janë të koncentruara pjesa më e madhe e instiucioneve më të rëndësishme komunale.

<sup>2</sup>Burimi: ASKDATA Popullsia e komunës së Kamenicës sipas vendbanimit, 2011.fq.29-30


Sipas regjistrimit të fundit në komunë janë gjithsej 6419 ekonomi familjare.

Tabela 4 Karakteristikat demografike të Komunës

	Zonë urbane	Zonë rurale	Gjithsejtë
Ekonomitë familjare	1,400	5,019	6,419
Numri i banorëve	7,331	28,754	36,085
Numri i banoreve femra	3,584	13,942	17,526
Numri i banorëve meshkuj	3,747	14,812	18,559

Grafiku.4 Struktura e banimit në zona urbane dhe rurale

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, vërehet një përqendrim i lartë i banorëve në zonë rurale, ku banojnë 79.68%, gjersa në zonë urbane banojnë vetëm 20.32% banorë.



Grafiku.5 Struktura gjinore

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, përqindja e banoreve femra është 48.57%, gjersa përqindja e banorëve meshkuj është 51.43% dhe nuk dallon në zona rurale/urbane.




**Struktura e moshës**- Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, grupmosha me më së shumti banorë është ajo e 10 – 19 vjeçarëve me 7,263 banorë, e përcjellë nga grupmosha 20-29 vjeçarëve me 6,074 banorë, grupmosha 30-39 vjeçarëve me 5,282 banorë, dhe grupmosha 0-9 vjeçarëve me 5,389 banorë.

Tabela 5. Popullsia sipas moshës

0-9	10-19	20-29	30-39	40-49	50-59	60-69	70-79	80+
5,389	7,263	6,074	5,282	4,644	3,293	2,196	1,450	494

Graf.6. Popullsia sipas moshës



Burimi: ASKDATA: Popullsia e Komunës së Kamenicës sipas grupmoshës 2011

**Migrimi**-Bazuar në të dhënat e ASK-së të vitit 2014, jashtë vendit jetojnë gjithsej 4,658 banorë të Komunës së Kamenicës, përkatësisht 2,140 banorë të gjinisë femërore dhe 2,518 banorë të gjinisë mashkullore.

Sa i përket vendeve ku kanë emigruar banorët e Komunës së Kamenicës, 2,620 banorë jetojnë në Zvicër, 1,105 jetojnë në Gjermani, 110 banorë jetojnë në Suedi dhe 110 banorë jetojnë në Amerikë.

Tabela 6. Numri i banorëve të Komunës së Kamenicës sipas shteteve në të cilat emigruan

Gjermani	Zvicër	Itali	Austri	Suedi	Amerikë	Francë	Angli	Belgjikë	Sloveni	Tjera
1,105	2,620	12	73	110	110	104	43	59	2	420
23.72%	56.25%	0.26%	1.57%	2.36%	2.36%	2.23%	0.92%	1.27%	0.04%	9.02%


## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

**Struktura Etnike**-Në Komunën e Kamenicës dominon komuniteti shqiptar me gjithsej 94.47% banorë, pastaj komuniteti serb me 4.31% banorë, rom me 0.67% banorë dhe 0.55% të tjerë.

Tabela 7. Popullsia sipas përkatësisë etnike

Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Të tjerë	Preferon të mos përgjigjet
34,186	1,554	5	9	240	0	0	27	4

Grafiku 7. Popullsia sipas përkatësisë etnike



**Struktura religjioze**-Në Komunën e Kamenicës dominon komuniteti mysliman me gjithsej 95.34% banorë, pastaj komuniteti ortodoks me 4.31% banorë dhe katolikë me 0.04%.


Tabela 8. Popullsia sipas përkatësisë religjioze

Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Pa religjion	Preferon të mos përgjigjet	Nuk janë në dispozicion
34,405	1,556	13	24	32	24	29



## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Grafiku 8. Popullsia sipas përkatësisë religjioze



<sup>2</sup>Burimi: ASK *Strukturura religjioze në Komunë, fq.29-30*

## ADMINISTRATA

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE - Komuna e Kamenicës ka gjithsej 11 drejtori të cilat janë prezantuar detajisht te struktura organizative e komunës (shih shtojcën më lartë).

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040, Komuna është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve. Si rezultat, Komuna e Kamenicës ofron shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040 dhe Ligjet tjera specifike.



Përgjegjësitë:

Zyra për Informim menaxhon ueb faqen e komunës. Kjo ueb faqe zyrtare u mundëson qasje më të lehtë qytetarëve në ngjarjet komunale, postimi i vazhdueshëm i dokumenteve dhe ngjarjeve të rëndësishme, që janë në interes për qytetarët e Komunës së Kamenicës. Qytetarëve të Komunës së Kamenicës përveç që u ofrohen shërbime të mira në komunë, atyre u ofrohen edhe shërbime elektronike nëpërmjet E-kioskut. Në zonat rurale, shërbimet e vetme administrative ofrohen përmes dy zyrave të gjendjes civile që gjenden në fshatrat Hogosht dhe Muçiverc.

Me gjithë vështirësitë që ka pasur Komuna e Kamenicës ka arritur t'i realizojë synimet dhe objektivat e parapara sipas ligjeve aplikative në fuqi, janë shumë të arritura dhe angazhime të administratës komunale, me qëllimin e vetëm pra që të arrihen kushte sa më të mira për qytetarët e komunës tonë.

Administrata komunale gjatë vitit 2022 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale për qytetarët, në riorganizimin profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente me media, OJQ, shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare, duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim, por edhe qasje transparente më qytetarët.

Gjatë vitit 2022 deri në fund të muajit tetor të këtij viti, Administrata Komunale në Kamenicë ka ofruar shërbime për qytetarë dhe biznese në total prej **40,696** shërbime administrative, të cilat më detajisht janë paraqitur në shtojcën më poshtë.

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Tabela 9. Raporti i shërbimeve sipas departamenteve

### Raporti i shërbimeve të departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 01.01.2022-31.12.2022

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar*	Në Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
	NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lende	0	13	0	0	0	0	0	0	0	13
<b>DAP</b>	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	98	30	2,230	3	0	0	1	8	25,270	27,640
<b>DA</b>	Drejtoria e Arsimit	32	0	770	195	0	0	0	4	0	1,001
<b>DBPZHR</b>	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	86	6	1,075	212	14	0	0	9	0	1,402
<b>DEFZH</b>	Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	67	2	1,261	0	0	0	0	0	0	1,330
<b>DKRS</b>	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	5	39	103	6	0	4	0	0	0	157
<b>DPKGJ</b>	Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë	28	34	172	3	1	0	0	1	0	239
<b>DI</b>	Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Diaspores	6	6	57	36	0	0	0	1	0	106
<b>DSHMS</b>	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	21	48	596	4	2	0	0	11	0	682
<b>DSHPA</b>	Drejtoria e Shërbimeve Publike Ambientit dhe Inspektoriatit	114	180	406	158	0	0	1	0	0	859
<b>DUPH</b>	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor	33	502	121	12	0	21	0	2	0	691
<b>DMSH</b>	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit	15	5	110	8	0	1	2	2	0	143
<b>KKK</b>	Kuvendi Komunal	51	80	239	2	0	0	0	5	0	377
<b>KKK</b>	Zyra e Kryetarit	369	3,898	1,747	15	0	0	9	18	0	6,056
		925	4,843	8,887	654	17	26	13	61	25,270	40,696

\*Kolona të pranuar paraqet kërkesat të cilat janë hapur në sistem por që nuk janë inicuar

Burimi: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme


## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Sipas burimeve të Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, ka një ndryshim përgjatë viteve për stafin e planifikuar dhe atij aktual, siç shihet edhe nga tabela e mëposhtme, sipas planifikimit në vitin 2014 janë 1166 punëtorë, ndërsa në fund të vitit 2022 kanë qenë 1189, respektivisht një rritje prej 23.

Tabela 10. Numri i të punësuarve 2014-2022

Numri i të punësuarve për periudhën 2014-2022									
Vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Stafi i planifikuar	1166	1166	1172	1172	1172	1186	1186	1186	1189
Stafi aktual	1210	1193	1192	1193	1170	1183	1152	1143	1116

Grafiku 9. Numri i të punësuarve 2014-2022



## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

**Tabela 11. Struktura kualifikuese, etnike dhe gjinore në Administratë**

Komuna	Totali	Struktura kualifikuese				Struktura etnike				Struktura		Pers.me aft.		Postet	
		Shkollimi				Sh	S	R	Të tjerë	gjinore		të kufizuar		politike	
		Fakul. Mast.	I lartë	I mesëm	Fillor					M	F	M	F	M	F
<b>Nepunes Civil</b>	241	124	6	103	8	215	24	2		176	65				

Duke analizuar strukturën kualifikuese në administratë, vijmë në përfundim se 51.45% e të punësuarëve kanë përgatitje të lartë apo fakulet, ndërsa të tjerët shkolla të larta apo të mesme.

**Tabela 12. Struktura kualifikuese, etnike dhe gjinore në Arsim**

Institucioni: ARSIMI														
DKA	Totali	Master	Struktura kualifikuese				Struktura etnike				Struktura		Pers.me aft.	
			Shkollimi				SH	S	R	Të tjerë	gjinore		të kufizuar	
			Fakul.	I lart	I mes.	Fill.					M	F	M	F
<b>Të punësu</b>	721	109	422	34	115	41	578	143	0		432	289		
<b>Nëpunës mbesht.</b>														

Nëse krahasojmë strukturën kualifikuese në arsim, atëherë rezulton që 15.11% të të punësuarëve janë me përgatitje master, 58.52% me fakulet, 4.71% me shkollë të lartë, 15.95% me shkollë të mesme, dhe 5.68% me përgatitje të ulët-filllore.

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Në sektorin e shëndetsisë kualifikimet rezultojnë të jenë më të ulëta, kjo për faktin e ndryshimit të strukturës të të punësuarve infermiereve, prandaj kjo normë e përqindjes së stafit me fakultete aktualisht është 37.01%.

**Tabela 13. Struktura kualifikuese, etnike dhe gjinore në shëndetësi**

Institucioni: Shëndetsia														
QKMF-Kamenicë	Totali	Struktura kualifikuese				Struktura etnike				Struktura gjinore		Pers.me aft. të kufizuar		Postet politike
		Shkollimi				SH	S	R	Të tjerë	M	F	M	F	M
		Fakul.	I lartë	I mes.	Fill..									
<b>Nëpunës publik</b>	<b>154</b> nga 161 te lejuar	<b>57</b>	<b>0</b>	<b>84</b>	<b>13</b>	<b>136</b>	<b>17</b>	<b>1</b>		<b>51</b>	<b>103</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	

Burimi: Administrata shëndetsi




**Arsimi-** Bazuar në ligjin e Arsimit në komnat e Republikës së Kosovës, ligjin e arsimit parauniversitar dhe udhëzimet administrative, DKA menaxhon me sistemin arsimor komunal, planifikon, organizon dhe monitoron funksionimin normal të shkollave, nxit bashkëpunimin ndërmjet shkollave dhe komunitetit në përgjithësi duke mundësuar ambient të përshtatshëm pune dhe siguri. DKA mundëson gjithëpërfshirjen në arsim duke siguruar qasje të barabartë në

institucionet parashkollore, arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, për të gjithë fëmijët pa dallim nacionaliteti, feje, gjinie apo race. Ky digaster planifikon zhvillimin profesional të mësimdhënësve, vlerësimin e performancës dhe llogaridhënien, ndërsa në bashkëpunim me MASHT, planifikon investimet në ndërtimin e objekteve arsimore, renovimin dhe izolimin e atyre ekzistuese, zbaton politika të reja arsimore që avansojnë nivelin e angazhimit profesional dhe arrijten e rezultateve dhe objektivave në përgjithësi.

Sistemi i Arsimit në Komunën e Kamenicës ka avancuar ndër vite, janë ndërtuar një numër i konsiderueshëm i objekteve arsimore dhe është bërë rikualifikimi i shumë mësimdhënësve. Shkollat në vazhdimsi janë pajisur me mjete didaktike dhe kabinete të ndryshme bashkëkohore si dhe po vazhdohet edhe tani me të njëjtën dinamikë deri në paisjen përfundimtare të tyre.

Në Komunën e Kamenicës punojnë dy(2) institucione parashkollore, 16 institucione të shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët, dhe pesë(5) institucione të shkollimit të mesëm lartë. Në shkollimin parafillor punojnë 25 punëtor, në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët punojnë 511 punëtorë, në shkollimin e mesëm të lartë punojnë 185 punëtor. Kualifikimi i mësimdhënësve është i dhënë në tabelën më poshtë. Krahas mësimdhënësve në shkollat e Komunës së Kamenicës punojnë edhe katër(4) pedagogë, tetë(8) psikologë, tetë(8) mësimdhënës asistentë për fëmijët më nevoja të veçanta dhe katër(4) logoped.

Grafiku 10 .Struktura kualifikuese e të punësuarve në institucionet arsimore



Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet arsimore në komunë është 721 punëtorë. Ashtu siç shihet edhe nga grafiku më sipër (109) 15% janë më përgatitje Master, (422) apo 58% janë me fakultet, (34) apo 5% me shkollim të lartë, (115) apo 16% shkolla e mesme dhe (41) apo 6% me kualifikim të ulët.

Infrastruktura e shkollave është e mirë, objektet shkollore janë të përshtatshme për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, furnizimi me ujë, ngrohje, qasje në kanalizim, gjendja e objekteve, gjendja e inventarit është gjithashtu e mirë me gjithsej 256 klasë, posedimi i kabineteve shkencore apo hulumtuese është 33.

Mesatarja e notës së nxënësve nëpër shkolla është: Arsimi Fillor 4.54, Arsimi i Mesëm i Ulët 4.05, dhe Arsimi i Mesëm i Lartë 3.61. Mesatarja e pikëve në testin e arritshmërisë është e dhënë në tabelën e mëposhtme.

Shtrirja e arsimit parashkollor është një(1) në qytet, dhe një(1) për disa fshatra, numri i fëmijëve është 144. Shtrirja e arsimit parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët është kryesisht në viset rurale përveç tri(3) shkollave në qytet, dhe numri i nxënësve është 2704, shtrirja e arsimit të mesëm i lartë është pesë(5) shkolla janë në qytet, dhe një(1) është në fshat, numri i nxënësve është 714. Numri i tërësishëm i mësimdhënësve është 492, ndërsa raporti mësimdhënës-nxënës është 1 me 7.24.

Gjithashtu në kuadër të IAAP „Andrea Durrsaku” në Kamenicë është edhe arsimi jo formal apo arsimi për të rritur në kuadër të të cilit mësimet i ndjekin 34nx. në këto drejtime: Elektroteknikë – profili informatikë tre(3) nxënës, dhe Instalues elektrik shtatë(7) nxënës, ndërtimtari 10 nxënës, makineri profile instalues i ujit, ngrohjes dhe klimatizim shtatë(7) nxënës, dhe metalpunues shtatë(7) nxënës. Nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen të kemi dhe forma tjera të



## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

organizimit të arsimit joformal për aftësimin më të shpejtë të kandidatve sipas kërkesës së tyre apo të kompanive të ndryshme të komunës sonë.

**Tabela 14. Numri i nxënësve sipas largësisë së udhëtimit në shkolla**

Shkollat	<1km	1-2km	2-3km	3-4km	4-5km	>5km	Gjithsej
<b>Filizat</b>	68	15	0	0	0	0	83
<b>Fan Noli</b>	262	62	33	10	1	23	391
<b>Metush Krasniqi</b>	0	173	15	5	0	1	194
<b>17 Shkurti</b>	1	121	0	0	0	0	122
<b>Abdullah Krashnica</b>	0	254	1	0	0	0	255
<b>Skënderbeu</b>	0	57	7	16	21	43	144
<b>Skënderbeu   1</b>	2	27	3	3	0	6	41
<b>Rexhep Mala</b>	0	142	1	3	0	0	146
<b>Sadri Misini</b>	0	65	127	0	0	0	192
<b>Avni Rrustemi</b>	0	85	0	0	0	0	85
<b>Asllan Thaçi</b>	0	78	6	0	0	0	84
<b>Xhavit Ahmeti</b>	0	144	0	0	0	0	144
<b>Hasan Prishtina</b>	0	64	0	0	9	0	73
<b>Xhelal Sopi</b>	0	79	0	0	0	0	79
<b>Ismail Qemali</b>	56	98	44	17	8	1	224
<b>Andrea Durrsaku</b>	0	32	21	35	3	70	161
<b>Desanka Maksimoviç</b>	17	66	39	7	0	0	129
<b>Desanka Maksimoviç- 1</b>	12	1	5	3	4	3	28
<b>Desanka Maksimoviç- 2</b>	11	18	7	1	1	2	40
<b>Desanka Maksimoviç -3</b>	29	19	1	0	0	0	49
<b>Desanka Maksimoviç- 4</b>	1	0	0	0	0	0	1
<b>Bratstvo</b>	2	1	10	3	1	9	26
<b>9 Maj</b>	3	2	8	3	0	0	16
<b>Gimnazija</b>	2	15	0	0	1	62	80
<b>Tehniçka shkolla</b>	7	18	15	7	10	22	79
<b>Dëshmorët e kombit</b>	0	405	0	0	2	57	464
<b>Sunçe</b>	10	9	0	3	3	0	25
<b>Sunçe - 1</b>	3	1	0	0	0	0	4
<b>Sunçe - 3</b>	8	10	1	0	0	0	19
<b>Sunçe - 4</b>	3	9	1	0	0	0	13
<b>Sejdi Kryeziu</b>	44	8	18	16	68	16	170
<b>Gjithsej</b>	541	2078	363	132	132	315	3561

Këtë vit shkollor testi i arritshmërisë është mbajtur në objekte të shkollave të mesme të larta të shpërndara në 2 (dy) qendra të testimit.

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë 2022, në mënyrë tabelare janë:

Tab. Testi i arritshmërisë

<i>Dita</i>	<i>Pjesa e parë</i>	<i>Nr.i nx.që kanë hy në test</i>	<i>Mesatarja e pikëve (%)</i>
<i>E parë</i>	gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi	252	54
<i>E dyta</i>	matematikë, informatikë, fizikë, kimi dhe biologji	252	46



**SHËNDETËSIA**-Sot sipas dinamikës dhe trendeve aktuale të vendeve të zhvilluara, komunat janë përgjegjëse për ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale me cilësi të lartë për të gjithë ata që kanë nevojë për to, pavarësisht moshës, racës, nacionalitetit apo llojit të sëmundjes. Shteti është përgjegjës për sigurimin e kornizës ligjore me kushte dhe mundësi të barabarta ligjore dhe financiare. Përveç kësaj, shteti mban përgjegjësinë e ushtrimit të

mbikëqyrjes dhe kontrollit ligjor në lëminë e shëndetësisë. Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të listës prioritare të projekteve ka inkorporuar edhe projektin për fuqizimin e infrastrukturës në kujdes parësor. Veprimtaria e kujdesit parësor shëndetësor përfshin promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostifikimin, mjekimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike mbështetur në konceptin e mjekësisë familjare. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve t’u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase të vazhdueshme individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në fakte shkencore përmes mjekut familjar si mjek i përzgjedhur, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve shëndetësore, dhe si pikë referuese për specialistët, konsultantët në KPSH dhe nivelet tjera të kujdesit shëndetësor. Në Komunën e Kamenicës shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore.

Në këtë kontekst, në Komunën e Kamenicës veprojnë dhe ofrojnë shërbime:

- 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF),
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe
- 17 Njësi të Kujdesit Ambulantor-Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF).

Në QKMF Kamenicë dhe QMF Roganë ofrohen shërbime 24h;

QMF Qendër 07:00 – 19:00h

QMF Hogosht 07:00 – 15:00h

Nga 17 Njësi të Kujdesit Ambulantor, 12 prej tyre janë jashtë funksionit.

Funksionale janë ato në fshatrat:


1. AMF Koretin 08:00 – 15:00
2. AMF Topanicë 08:00 – 15:00
3. AMF Karaçevë 08:00 – 15:00
4. AMF Shipashnicë 08:00 – 15:00
5. AMF Bosce 08:00 – 15:00

Mosfunionimi i disa nga AMF- të në disa fshatra është si pasojë e mungesës së stafit mjekësor ku kanë ndikuar dy (2) faktorë: migrimi i personelit mjekësor dhe ndarja e specializimeve e po ashtu edhe migrimi i banorëve në qytet.

Ministria e Shëndetësisë për një kohë të gjatë nuk ka ofruar mundësinë për lejimin e specializimeve, kjo ka ndikuar në grumbullimin e mjekëve të rinj që kanë mbetur pa specializime. Pas zhbllokimit të këtij procesi nga Ministria e Shëndetësisë, nevoja dhe interesimi i lartë i mjekëve për specializime ka sjellur vështirësi në mjekësinë primare nëpër komuna, e ndër to edhe në Komunën e Kamenicës.

(Në specializim nga Komuna e Kamenices janë pesë(5) mjek).

**Tabela 15. Shërbimet e Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) - Kamenicë**



Vlenë të theksohet se për herë të parë në vitin 2022 në qendrën tonë po ofrohen edhe shërbimet e mamografisë, i cili ka munguar deri tani, dhe numri i shërbimeve të ofruara është për 1809 vizita.

Infrastruktura gjithashtu është njëra ndër sfidat e cila shpie në mosfunktionalizimin e AMF-ve, përkatësisht mosintervenimi ndër vite në AMF-të e Komunës së Kamenicës e që ka ndikuar te qytetarët duke e zbehur interesimin për të kërkuar shërbime shëndetësore.

Qeverisja aktuale, tanimë ka inicuar procedurat për hartimin e një strategjie efikase dhe ka në plan përmirësimin e infrastukturës në AMF-të e komunës, njëherit është formuar një ekipë mobile e cila do jetë në vazhdimësi në shërbim të qytetarëve, varësisht prej nevojave të qytetarëve.



**MIRËQENIA SOCIALE** - Sistemi i mirëqenies sociale është një rrjet programesh dhe aktiviteteve i krijuar për të ndihmuar qytetarët e një vendi në të gjitha fazat e jetës së tyre. Ky sistem është rezultat i angazhimit të shtetit dhe qeverisë ose organizatave për të siguruar dhe rritur mirëqenien sociale. Është një proces i vazhdueshëm që synon të kujdeset për nevojat specifike të shoqërisë. Përmes programeve të mirëqenies sociale, qytetarët mbrohen nga pasiguritë e ndryshme të jetës.


**Qendra për punë sociale:** Në Komunën e Kamenicës funksionon Qendra për punë sociale e cila merret me çështje të rëndësishme sociale siç janë: shfrytëzuesit e ndihmave sociale për të gjithë qytetarët pa dallim, pastaj banimi social, shëndeti mendor, shtresat e ndryshme të shoqërisë duke përfshirë të moshuarit, integrimin e personave me çrregullime të ndryshme etj. Të dhënat nga Qendra për Punë Sociale në Komunën e Kamenicës lidhur me numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve, nëna me asistencë sociale, paraqesin një shkallë të lartë të varfërisë. Sipas këtyre të dhënave, për periudhën 2018-2021 rezultoi se në Komunën e Kamenicës përfitojnë 2276 persona, apo mesatarisht 608 familje që jetojnë me asistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varfëri të theksuar. Por siç shihet në tabelën e mëposhtme, për periudhën krahasuese, ka një tendencë simbolike të zvogëlimit të numrit të përfituesve në vitet e fundit nga vitet paraprake.

Tabela 16. Përfituesit nga skema sociale 2018-2021

Vitet	Nr. i familjeve	Përfituesit
2018	646	2451
2019	612	2149
2020	586	2249
2021	588	2256
2022	514	1956

Burimi: Drejtoria Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale

**Grafiku 11. Përfituesit nga skema sociale 2018-2021**



Burimi: Drejtoria Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

**Skema për familje me fëmijë me aftësi të kufizuara (0-18)**

Në vitin 2019, nga 5 kërkesa të parashtruara pranë komisionit mjekësor, një(1) është aprovuar, ashtu që gjithësej 36 Familje janë në pagesë. Në vitin 2020, nga 10 kërkesa të parashtruara pranë komisionit mjeksësor, pesë (5) janë aprovuar, ashtu që gjithësej 34 familje janë në pagesë. Në vitin 2021, nga 8 Kërkesa të parashtruara pranë komisionit mjekësor, dy(2) janë aprovuar, ashtu që gjithësej 32 familje janë në pagesë.

**Tabela.17 Skema për familje me fëmijë me aftësi të kufizuara (0-18)**

Vitet	Nr. i perfituesve
2019	36
2020	34
2021	32

Burimi: Drejtoria Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale

**Shërbimet Sociale Rezidenciale** – Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore sipas Marrëveshjes në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Kamenicës, nga Janari 2016 ka kaluar nën menaxhimin e Komunës, gjegjësisht nën ombrellën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Shtëpia e Komunitetit është një institucion rezidencial, në të cilin janë të vendosur 12 persona (rezidentë) me aftësi të kufizuara mendore me qëndrim 24 orë. Shtëpia e Komunitetit sipas rregullores së punës është e obliguar t'i përmbushë të gjitha nevojat rreth përkujdesjes së përgjithshme të rezidentëve të saj, duke filluar nga përkujdesja shëndetësore, ushqimi, higjiena, akomodimi, veshëmbathja, puna okupuese dhe rehabilituese, integrimi i tyre në shoqëri etj.

Ndër objektivat kryesore është sigurimi i kushteve për përkujdesjen dhe mirëqenien e përgjithshme të rezidentëve, përkujdesja ndaj ambientit të përgjithshëm të rezidentëve, ofrimi i shërbimeve të nevojshme shëndetësore si dhe rehabilitimi dhe integrimi i tyre në shoqëri – komunitet.

Shtëpia e Komunitetit – Kamenicë (ShKK) ka kapacitetet 10 shtretër për 10 persona, gjendja aktuale 12 persona.

Rezidentët janë nga: Komuna e Kamenicës, Gjilanit, Vitisë, Prishtinës dhe Novobërdës. Struktura e tyre etnike: tetë(8) Shqipëtarë, dy(2) Serb dhe dy(2) Rom.

Struktura gjinore: nëntë(9) femra, tre(3) meshkuj.

## INFRASTRUKTURA

**Ujësjetllësi** - Në sistemin e ujit nga 58 lokalitete që janë në total, prej tyre 9 (Nëntë) janë të përfshira në sistemin e ujësjetllësit që menaxhohet nga KRU Hidromorava, ndërsa në rrjetin e kanalizimit janë të përfshira 3 (tri) lokalitete që menaxhohen nga KRU “Hidromorava”.


Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, në total janë 6419 ekonomi familjare (EF), ku në ujësjetllës janë të përfshira 3952 EF, nga 59 Institucione publike, 53 janë të përfshira, dhe nga 527 biznese aktive, 197 janë të përfshira në sistemin e ujësjetllësit.

**Tabela 18. Lokalitetet që menaxhohen nga KRU “Hidromorava”, në sistemin e ujit dhe kanalizimit, duke përfshirë edhe institucionet publike dhe bizneset aktive**

Nr.	Lokaliteti	Furnizimi me ujë				Kanalizimi			
		EF	Instit.	Biznese	TOTAL	EF	Instit.	Biznese	Totali
1	Kamenicë	1953	30	172	2155	1953	30	172	2155
2	Berivojcë	312	3	10	325	312	3	10	325
3	Ruboc	32	-	-	32	32	-	-	32
4	Topanicë	483	5	11	499	-	-	-	-
5	Koretin	389	2	-	391	-	-	-	-
6	Kopernicë	233	3	3	239	-	-	-	-
7	Kolloleq	63	4	1	67	-	-	-	-
8	Shipashnicë e Ep.	284	3	-	287	-	-	-	-
9	Karaçevë e Poshtëme	203	3	-	206	-	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>3952</b>	<b>53</b>	<b>197</b>	<b>4202</b>	<b>2297</b>	<b>33</b>	<b>182</b>	<b>2512</b>




Grafiku12. Qasja në ujësjellës



Në sistemin kanalizimit nga 6419 EF, janë të përfshira 2297 EF, nga 59 institucione publike, 33 janë të përfshira, dhe nga 527 biznese aktive, 182 janë të përfshira në sistemin e kanalizimit. Këto të dhëna janë vetëm në ato lokalitete ku ujësjellësi dhe kanalizimi menaxhohet nga KRU "Hidromorava".

Grafiku 13. Qasja ne kanalizim



**INFRASTRUKTURA TEKNIKE****Infrastruktura dhe Furnizimi me ujë****Burimet dhe kapaciteti**

Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit në Komunën e Kamenicës menaxhohet nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Hidromorava" njësia në Kamenicë. Komuna e Kamenicës furnizohet

Tabela 19. Burimet e ujit të pijes

Vendburimet	Nr. i puseve	Lokacioni	Kapac. mujor mesatar	Komente
Stacioni 1	4 të hapura + 3 me shpim	Lagjja Malësia	2,9-3l/sec	
Stacioni 2	3 puse me shpim (1 funksional, 2 s'kanë ujë)	Qendra e qytetit	3.8-4l/sec	
Stacioni 3	1 pus me shpim	Grizime	Rreth 1l/sec (ne bazë të kërkesës)	
Stacioni 4	2 puse me shpim	Bashqe	6.5-7l/sec	
Stacioni 5	2 puse me shpim që gjenden në lokacionin e stacionit 1	Çamëria	1-1.5l/sec	
Stacioni 6	2 puse	Koretin	2l/sec	Verës ka mungesë
Stacioni 7	2 puse	Topanicë	3.5l/sec	
Stacioni 8	2 puse	Karacevë e poshtme	2.5-3l/sec	Satbil
Stacioni 9	4 puse që i mbushin 2 rezervoarë	Kopernicë (i furnizon Shipashnicë dhe Kopernicë, Kolloleq)	2.2-2.5l/sec	Stabil
Stacioni 10 (ne proces)	2 puse me shpim	Muqivërc	20l/sec	
Stacioni 11 (në proces)	2 puse me shpim	Hogosht	Ende nuk dihet	

me ujë të pijes nga burimet nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve me anë të pompave.

Në total, kapaciteti eksploatues i ujit nga këto burime është rreth 50.000m<sup>3</sup> në muaj, dhe 725.932m<sup>3</sup>/vit ndërsa 19.34 litra/sec) për vitin 2022.

Në Kamenicë ka 5 fabrika për trajtimin e ujit të pijshëm: Hogosht, Bujnoc, Zajçec, Gmicë dhe Tërstenë.

Qyteti i Kamenicës, vendbanimi Berivojcë dhe një pjesë e Rubocit, furnizohen me ujë nga dy stacione pompimi. Sasia më e madhe e ujit në këto stacione vjen nga sistemi i drenazhimit i vendosur nën shtratin e “LUMIT TË SHTREMBËR”, i cili bënë furnizimin e katër (4) puseve të hapura dhe tri (3) puseve të shpuara, nga të cilët përmes pompave horizontale dhe zhytëse mbushet rezervuari me kapacitet prej m<sup>3</sup>, dhe pastaj me anë të pompave tjera bëhet shpërndarja në rrjetin kryesor të ujit.

Pjesa më e madhe e banorëve të Komunës së Kamenicës që jetojnë në zonat rurale, furnizohen me ujë të pijshëm nga burime të ndryshme individuale (puse të hapura, kroje malore, lumenjë etj.). Këto burime të ujit nuk janë të testuara për cilësi nga institucionet përkatëse.

Përveç Koretinit dhe Karaçevës së Poshtme (e cila pas defektit eventual nuk mund të jetë stabile), furnizimi në komunë është i mirë dhe cilësia e ujit matet në intervale të përditshme.

#### Gjendja fizike e rrjetit të ujësjellësit

Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit në të gjithë komunën është L=72000.00m'. Gjendja e rrjetit është mjaft e mirë, duke qenë se janë zëvendësuar një sasi e madhe e gypave të azbestit me ato të polietilenit. Humbjet mesatare janë rreth 40%. Në vitin 2021 dhe 2022, është rreth 90% ujë nga sasia e përgjithshme e ujit të prodhuar, duke marrë parasysh edhe inkasimin e borxheve të vjetra.

#### Mbulimi me shërbim të ujësjellësit

Më poshtë janë paraqitur vendbanimet që kanë qasje në rrjet të ujësjellësit që menaxhohet nga KRU “Hidromorava” – njësia Kamenicë.

Tabela 20. Vendbanimet me shërbim të ujësjellësit që ofrohet nga KRU” Hidromorava “

Nr	Vendbanimet	Burimi dhe Kapaciteti	Nr. i banorëve (në 2011)	Nr. i konsumat. (dhjetor 2022)
1.	Kamenicë	Malësia, Qendra e Qytetit dhe Grizime (Q=42l/s)	7,331	2,155
2.	Berivojcë	Malësia, Qendra e Qytetit dhe Grizime (Q=42l/s)	1,553	325
3.	Ruboc	Malësia, Qendra e Qytetit dhe Grizime (Q=42l/s)	386	32
4.	Koretin	2 puse vetanake (Q=40l/s)	3,476	391
5.	Topanicë	2 puse vetanake (Q=36/s)	2,890	499
6.	Petrocë	2 puse vetanake (Q=16/s)	1,257	
7.	Kopërnice	2 puse vetanake (Q=18/s)	1,183	239
8.	Kolloleq	2 puse vetanake (Q=12/s)	181	68
9.	Shipashnicë e Epërme	2 puse vetanake (Q=14/s)	1,261	287

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

10.	Muçiverc	Në proces	1520	Ende nuk kanë
11.	Shipasnicë e Poshtme	Në proces	953	Ende nuk kanë
12.	Hodonovc	Në proces	2,446	Ende nuk kanë
13.	Rogaçicë	Në proces	2,450	Ende nuk kanë
14.	Novosellë	Në proces	280	Ende nuk kanë
15.	Dajkoc	Në proces	373	Ende nuk kanë
16.	Hogosht	Në proces	1705	Ende nuk kanë
<b>Gjithsej</b>				<b>4202</b>

Vendbanimet që nuk kanë rrjet të ujësjellësit janë:

Bllatë, Boscë, Bratilloç, Busavatë, Dajkoc, Dazhnicë, Desivojcë, Feriqevë, Grizimë, Gmicë, Gogolloc, Gragjenik, Gjyrishec, Hajnoc, Karaçevë e Epërme, Krilevë, Kostadincë, Kranidell, Kremenatë II, Lajçiq, Lisockë, Leshtar, Marocë, Meshinë, Moçar, Poliçkë, Qarrakoc, Rahovicë, Strezoc, Sedllar, Strelcë, Svirçë, Shahiq, Tërstenë, Tugjec, Vaganesh, Velegllavë e Epërme, Velegllavë e Poshtme, Vriçec, Zajçec dhe Zhujë, me numër prej 15,310 banorë.

**Tabela 21. Numri i banorve që kanë qasje në ujësjellës**

	Numri	Banorë	%
Vendbanimet me shërbim të ujësjellësit të menaxhuar nga KRU Hidromorava	9	19,518	56
Vendbanimet që nuk kanë qasje në shërbim të ujësjellësit	40	15,310	28
Vendbanimet që janë në proces të vendosjes së shërbimit	7	9,727	16

Në Komunën e Kamenicës 56% e banorëve kanë qasje në ujësjellës dhe 44% nuk kanë qasje. Nga 44% që nuk kanë qasje, për 16% të tyre rrjeti i ujësjellësit është në proces të ndërtimit, që do të zbret përqindjen në 28%.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur trendi i kapacitetit të prodhimit të ujit për 10 vitet e fundit.

**Tabela 22. Trendi i prodhimit të ujit në m<sup>3</sup> për vitet 2013 deri 2022**

Viti	Prodhimi m <sup>3</sup> qytet	Prodhimi / m <sup>3</sup> fshatra	Prodhimi m <sup>3</sup> Totali
2013	535198		535198
2014	569580		569580
2015	596335		596335

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

2016	625903		625903
2017	610665		610665
2018	488274	49117	537391
2019	501434	282334	783768
2020	442079	232513	674592
2021	546444	241307	787751
2022	451947	273985	725932

### Infrastruktura e kanalizimit

Pjesa dërrmuese e Komunës së Kamenicës kanë qasje në rrjet të kanalizimit.

Vendbanimet që nuk kanë rrjet të kanalizimit janë: Bllatë, Boscë, Bratilloç, Busavatë, Dajkoc, Dazhnicë, Desivojcë, Feriqevë, Gmicë, Gogolloc, Gragjenik, Grizimë, Gjyrishec, Hajnoc, Kopërnice,

**Tabela 23. Vendbanimet që kanë qasje në rrjet të kanalizimit**

Nr	Vendbanimet	Nr i Banorëve	Nr i konsumatorëve	Gjatësia (m)	Kapaciteti i shkarkimit (l/s)
1	Berivojcë	1553	1553 (305)	1800	
2	Hodonoc	2446	2446		
3	Kamenicë	7331	7331 (2181)		
4	Karaçevë e Poshtme	940	940 (206)		
5	Kopërnice	1183	1183 (240)		
6	Muçiverc	1520	1520		
7	Novosellë	311	311		
8	Petroc	1257	1257		
9	Rogaçicë	2668	2668		
10	Ruboc	386	386 (32)		
11	Shipashnicë e Epërme	1261	1261(288)		
12	Shipashnicë e Poshtme	753			
13	Hogosht	1705			
14	Karaçevë e Epërme	1413			
15	Kolloleq	181	65		
16	Koretin	3476	394		
17	Topanicë	2061	499		

\*Shifrat ne Kllapa me ngjyre te Kaltert jane në menaxhimin e Kru"Hydromorava" ndërsa me te kuqe në kllapa janë Konsumatorë në Ujësjellës, ndërsa ne Kanalizim nuk menaxhohen nga Kru"Hydromorava"



**RRUGËT**-Në Komunën e Kamenicës (në zonat urbane dhe në vendbanimet rurale), nga gjithsej 474 km rrugë lokale, të asfaltuara në total janë 263.80 km. Vetëm në zonat urbane të komunës janë 35.20 km rrugë. Nga totali i rrugëve, 221,5 km mirëmbahen nga organet komunale (sezona verore dhe dimërore).

Infrastruktura përcjellëse e rrugëve me trotuar, në zonat urbane dhe në vendbanimet rurale vetëm për vitin 2021 janë 1.76 km, ndërsa gjithësej janë 22.56 km.

Me ndriçim publik në total janë të pajisura 101.26 km rrugë, nga të cilat në vitin 2021 janë 15.36 km. Rrugë me sinjalizim vertikal dhe horizontal janë 80 km.

### Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbërta publike

DSHPAI në kuadër të mirëmbajtjes menaxhon me këto hapësirat si në tabelën më poshtë:

Tabela 24. Hapësirat e gjelbërta publike

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )
1	Mirëmbajtja intensive e hapësirave gjelbëruese	67,493
2	Pastrimi i lumit të qytetit	43,500
3	Varrezat e dëshmorëve dhe lapidarët	31,886
<b>Sipërfaqja e përgjithshme (m<sup>2</sup>)</b>		<b>142,879</b>

### Transporti lokal, linjat urbane dhe urbane-periferike, dhënia e lejeve për Taxi

Numri i vendndalimeve për automjetet e transportit publik është 62 vende. Nga këto vendndalime 11 vende janë të pajisura me shenjzime përkatës. Pjesa dërmuese e këtyre vendndalimeve janë në rrugët regjionale dhe është kompetencë e MI-së për vendosjen e tyre. Numri i lokaliteteve të përfshira nga operatorët transportues duke llogaritur edhe numrin e linjave ndër komunale, janë gjithsej 41 lokalitete nga 58 sa janë në total. Për 17 lokalitete tjera kryesisht vende kodrinore malore, nuk kemi pasur kërkesa, pasi edhe ka një frekuentim shumë të vogël të qytetarëve.


Tabela 25. Numri i parkingjeve

Nr	Emërtimi	Nr. i vendeve, parkingjeve
1	Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike	14
2	Numri i vend parkimeve	750
3	Numri i vend parkimeve për Taxi.	68
4	Numri i parkingjeve në vend parkime për persona me aftësi të kufizuara	14

### Menaxhimi i mbeturinave dhe zgjerimi i rrjetit nëpër lokalitete

Numri i përgjithshëm i klientëve që pranojnë shërbime nga sistemi i mbeturinave është 4915 konsumatorë, prej tyre 4430 janë ekonomi familjare, 426 janë ekonomi biznesi dhe 59 janë institucione publike. Në këtë vit janë faturuar 282,003.21€, të inkasuara janë 263,030.96€, që do të thotë se inkasimi është bërë 93.27%, ndërsa brenda vitit janë deponuar 5,493.55 ton mbeturina.

Grafiku.14 Qasja në sistemin e mbeturinave



Siç shihet edhe nga grafika e mësipërme, nga gjithsej 4915 konsumatorë që pranojnë shërbimet nga kompania Eco-Higjiena, 90.13% janë ekonomi familjare, 8.67% janë biznese dhe pjesa tjetër prej 1.20% institucione publike.

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027**

**Tabela 26. Sasia e mbeturinave të grumbulluara në ton(t)**

Nr.	Muaji	Sasia e mbeturinave të grumbulluara ton (t)			
		2018	2019	2020	2021
1	Janar	265.60	271.76	351.77	379.36
2	Shkurt	201.30	261.40	292.44	349.95
3	Mars	256.24	274.40	327.42	417.76
4	Prill	309.86	321.00	382.06	383.14
5	Maj	323.09	333.91	363.82	458.64
6	Qershor	302.01	322.28	399.86	470.58
7	Korrik	457.60	409.99	486.98	564.98
8	Gusht	463.09	481.04	489.57	637.86
9	Shtator	336.71	392.28	496.85	527.66
10	Tetor	340.32	373.59	436.76	449.82
11	Nëntor	282.74	331.95	454.92	443.26
12	Dhjetor	270.10	200.98	441.52	410.54
	<b>Gjithësej</b>	<b>3808.66</b>	<b>3974.58</b>	<b>4923.97</b>	<b>5493.55</b>





**Ndriçimin publik**- Në Komunën e Kamenicës aktualisht janë 3462 trupa ndriçues apo rreth 138.48 km gjatësi të rrjetit me ndriçim publik në të gjitha lokalitetet e komunës tonë. Në tabelën e më poshtme janë paraqitur numri i të gjithë trupave ndriçues në të gjithë territorin e Komunës së Kamenicës, gjithashtu edhe të gjatësisë së rrjetit sipas lokaliteteve.

Tabela 27. Shtrirja e ndriçimit publik(m)

Shtrirja e rrjetit të Ndriçimit publik sipas lokaliteteve			
Nr.	Lokalitetet	Trupa ndriçues në (copë)	Gjatësia e rrjetit në (m)
1	Berivojcë	109	4360
2	Boscë	35	1400
3	Busavatë	66	2640
4	Dajkoc	44	1760
5	Hajnoc	42	1680
6	Hodonoc	227	9080
7	Hogosht	157	6280
8	Kamenicë	849	33960
9	Karaçevë e Epërme	130	5200
10	Karaçevë e Poshtme	182	7280
11	Kolloleq	21	840
12	Kopërnice	88	3520
13	Koretin	284	11360
14	Krilevë	34	1360
15	Moçar	19	760
16	Muçiverc	221	8840
17	Novosellë	25	1000
18	Petroc	89	3560
19	Rogaçicë	265	10600
20	Ruboc	82	3280
21	Strezoc	67	2680
21	Shipashnicë e Epërme	99	3960
22	Shipashnicë e Poshtme	61	2440
23	Topanicë	266	10640
<b>GJITHËSEJT</b>		<b>3462</b>	<b>138,480.00</b>



### Qasja në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit-

Duke u bazuar në të dhënat e fundit nga ASK për vitin 2022, për ekonomitë familjare në Kosovë që kanë pasur qasje në internet, rezulton se rreth 97.9% të ekonomive familjare kanë pasur qasje në internet nga shtëpia apo banesa. Grupmosha që ka pasur qasje në internet me përqindje më të lartë është grup-mosha 35-44 vjeç me 21,8%.

Për përdoruesit sipas gjinisë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa, të dhënat tregojnë se përdorimi i internetit nga meshkujt dominon me 55.2%, krahasuar me femrat me 43.6%.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI, SPORT

Në kuadër të kësaj drejtorie funksionojnë disa sektore në hapësira të ndryshme. Gjithashtu kjo drejtori është përgjegjëse për organizimin e një sërë manifestimesh tradicionale, avancimin e mbarëvajtjen e jetës kulturore, ngjarjeve sportive e aktiviteteve rinore. Më poshtë do të radhisim sektorët dhe njësitë që funksionojnë në kuadër të kësaj drejtorie:

- Sektori për Kulturë
- Sektori për Sport
- Sektori për Rini
- Zyra për Trashëgimi Kulturore
- Biblioteka e Qytetit
- Arkivi Historik Komunal

### Sektori për Kulturë



#### Foto nga përformaca e balerinave të vogla me rastin 14 vjetorit të pamvarsisë së Kosovës

Ky sektor është përgjegjës për zhvillimin e jetës kulturore në përgjithësi në komunën tonë, duke përfshirë këtu disa fusha të artit si muzika, teatri, filmi, piktura, fotografia, këngët dhe vallet, letërsia etj. Gjatë një viti kalendarik, ky sektor merret me shënimin e disa datave dhe manifestimeve tradicionale siç janë:

Flaka e Janarit, Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurti), Epopeja e UÇK-së (5-6-7 marsi), Lulëkuqet e Prillit, Qershori i Lirisë (18 qershori, Dita e Çlirimit të Kamenicës), Ditët e Diasporës, Dita e Flamurit (28 nëntori), si dhe data tjera të shënuara si: 1 Qershori – Dita e Fëmijëve, Dita Ndërkombëtare e Librit etj.

Përveç shënimit të këtyre datave të rëndësishme, Sektori për Kulturë ndihmon edhe artistët dhe performuesit e fushave të ndryshme në organizimin e shfaqjeve, ekspozitave, performancave etj.

## Sektori për Sport



### Foto nga turniri tradicional në futboll të vogël në Roganë

Sektori për Sport përveç menaxhimit që i bën Palestrës së Qytetit dhe Stadiumit të Qytetit “Agush Isufi”, ku zhvillojnë aktivitetet e tyre shumë klube sportive, merret dhe ndihmon në organizimin e garave, turneve dhe ngjarjeve të ndryshme sportive komunale, regjionale e kombëtare, si:

Përzgjedhja e Sportistit të Vitit, Garat në Shah, Turneu tradicional në Ping-Pong “Musa Thaçi”, Mini-turneu tradicional në Futsall “Epopeja e UÇK-së,” Krosi Pranveror, Garat sportive në kuadër të Ditëve të Diasporës në: StreetBall, BeachVollej, Not, Turneu Tradicional në Futboll të Vogël “Rogana” etj.

Sportistët, aktivitetet e tyre i zhvillojnë në terrene dhe fusha jo të përshtatshme, me infrastrukturë që lë akoma lë për të dëshiruar. Edhe pse ka mjaft hapësira për zhvillim të aktiviteteve sportive me gjithsej 98203 m<sup>2</sup>, jo të gjitha janë të përshtatshme për një gjë të tillë.

Në Komunën e Kamenicës funksionojnë gjithësej 15 klube sportive:

K.A. Rogana ,K.F. Kika ,K.F. Besa, K.F. Dardana10, K.V. Feniks F, Klubi i Peshkimit Mlyshi, Klubi i Badmintonit Arbëria, Klubi i Karates Arbëria, Shkolla e Futbollit Dardana, Klubi i Shahut Dardana, K.V. Feniks M, Klubi I Badmintonit Rogana, Klubi Triathlonit Dardana, Klubi i Çiklizmit Dardana, Klubi i Skijimit Kika.

Nga komuna jonë viteve të fundit kanë dalë disa sportistë elitare si:

Musa Hajdari (atletikë), Diana Kryeziu (atletikë), Emir Kryeziu (atletikë), Lirim Kastrati (futboll), Donat Rrudhani (futboll), Emir Lenjani (futboll), Hekuran Kryeziu (futboll), Edona Kryeziu (futboll), Kaltrina Biçku (futboll), Merita Borovci (futboll).

### Sektori për Rini



#### Foto nga aktivitet e KVRL-së me të rinjët në Kamenicë

Sektori për Rini merret me organizimin e aktiviteteve rinore me karakter edukativ, përmbajtësor, me qëllim të zhvillimit të mendimit kritik, aktivizimit qytetar, aftësive të buta, etj. Ky sektor organizon debate, kurse, trajnime, puntori, ekspozita, gara e lojëra të ndryshme, aksione simbolike etj. Tashmë së fundmi ka një fokus akoma më të shtuar ndaj sektorit të rinisë, sepse me planet buxhetore ka një linjë të veçantë për financimin e aktiviteteve rinore.

## Zyra për Trashëgimi Kulturore



### Foto e shtëpisë së “Avdyl Cakollit” në Krilevë (Shek.XIX)

Në Komunën e Kamenicës gjenden më shumë se 40 asete të mbrojtura të trashëgimisë kulturore arkeologjike e arkitekturore. Zyra për Trashëgimi Kulturore në Komunën e Kamenicës, bënë vizita sistematike nëpër këto lokalitete e objekte, me qëllim të observimit të gjendjes dhe raportimit tek institucionet relevante qendrore, angazhohet në sigurimin e fondeve, nga institucionet apo organizatat që merren me trashëgiminë kulturore, për konservimin dhe restaurimin e objekteve etj. Poashtu organizon ekspozita me motive nga trashëgimia jonë kulturore, vizita në terren me nxënës ose delegacione të ndryshme që vizitojnë komunën etj.

Në dokumentin Lista e Trashëgimisë për Mbrojtje të Përkohshme (Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport) nga Komuna e Kamenicës gjenden gjithsej 47 asete, prej tyre:

- 21 nga kategoria arkeologjike
- 22 nga kategoria arkitekturore
- 4 nga kategoria objekte te luajtshme

## LISTA E TRASHËGIMISË KULTURORE PËR MBROJTJE TË PËRKOSSHME (Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport)

Nga dokumenti i lartëshënuar janë shkëputur asetet e Komunës së Kamenicës

## 28. Lista e trashigimisë kulturore

I. Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike					
A. Nënkatëgoria: Monument/Ansambël					
Nr.	Emërtimi	Periudha	Vendi/Komuna	Statusi	Nr. unik në databazë
62	Kisha e Dëftimit të Shën Mërisë	Mesjetë	Vaganesh, Kamenicë		854
63	Manastiri 'Qeli' (Burg)	Mesjetë	Hajnoc, Kamenicë		856
64	Manastiri i Moçarit	Mesjetë	Moçarë, Kamenicë		780
65	Kisha e Shën Gjonit	Mesjetë	Berivojcë , Kamenicë		895
376	Kalaja e Kamenicës (Dardanë)	Parahistori, Antikitet i Vonë	Kamenicë		1198
377	Gërmadhat e varrit të antikës së vonë në Hogosht	Antikitet i Vonë	Hogosht, Kamenicë		3030
378	Lokaliteti arkeologjik 'Ordine'	Romake	Karacevë e Epërme, Kamenicë		2887
379	Themelet e kishës në Karacevë të Epërme	Antikiteti i Vonë, Mesjetë	Karacevë e Epërme, Kamenicë		3709
380	Lokaliteti arkeologjik-Bregu i Gjytetit-Gjyrishec	Antikë	Gjyrishec, Kamenicë		3623
381	Kalaja e antikitetit të vonë në Topanicë	Antikitet i Vonë	Topanicë, Kamenicë		1197

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027**

382	Fortifikata - Kalaja e Krilevës	Antikitet i Vonë	Krilevë, Kamenicë		3385
383	Kalaja e antikitetit të vonë në Kranidell	Antikitet i Vonë	Kranidell, Kamenicë		1199
384	Kodërvarret Ilire në Zajqec	Parahistori	Zajqec, Kamenicë		3731
424	Vendbanimi Kërshi i Madh / Livadhet	Antikë e Vonë	Busavatë-Rubovc, Kamenicë		4493
425	Kulina - Kalaja e Strezocit	Antikë e Vonë	Hajnoc, Kamenicë		4494
426	Lokaliteti Bara e Bixhës	Romake - Antikitet i Vonë	Hogosht, Kamenicë		4495
427	Gërmadhat e Kishës	Mesjetë	Lisockë, Kamenicë		4496
428	Vendbanimi Katune	Antikë e Vonë - Mesjetë	Karacevë e Ulët, Kamenicë		4497
429	Vendbanimi Brege	Romake	Koretin, Kamenicë		4498
430	Arat e Kooperativës	Neolit	Strezoc, Kamenicë		4499
431	Vendbanimi Suishtë	Neolit	Topanicë, Kamenicë		4500

**II. Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore**

**A. Nënkatëgoria: Momument/Ansambël**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Periudha</b>	<b>Vendi/Komuna</b>	<b>Statusi</b>	<b>Nr. unik në databazë</b>
782	Shtëpia e Demush Ferizit	Shek. XIX	Zhujë, Kamenicë		791
783	Xhamia në Zhujë	1816	Zhujë, Kamenicë		2692
784	Shtëpi Banimi në	Shek. XIX	Leshtarë, Kamenicë		800



**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027**

	Leshtarë (Jusuf Ademi)				
785	Mulliri i Jashar Hysës	1839-1850	Leshtarë, Kamenicë		4252
786	Shtëpia e Rahim Sadikut (Shtëpia ku u strehuar Mulla Idrizi)	Shek. XIX	Gjyrishec, Kamenicë		812
787	Shtëpia e Abdyl Cakollit	Shek. XIX	Krilevë, Kamenicë		828
788	Xhamia në Krilevë	1846	Krilevë, Kamenicë		311
789	Teqja e Sheh Zenel Abedinit	Shek. XVIII	Topanicë, Kamenicë		2690
790	Shtëpia Muze e Kadri Zekës	Shek. XIX	Polickë, Kamenicë		841
791	Shtëpia e Hamdi Arif Rashitit	Shek. XX	Velegllavë, Kamenicë		849
792	Mulli Binjak në Hogosht	Shek. XX	Hogosht, Kamenicë		839
793	Pendat në Hogosht	1950	Hogosht, Kamenicë		90
794	Xhamia në Busavatë	1938	Busavatë, Kamenicë		294
795	Xhamia në Kranidell	1928	Kranidell, Kamenicë		269
796	Xhamia në Meshinë	1886	Meshinë, Kamenicë		245
797	Xhamia në Vryqec	1826	Vryqec, Kamenicë		246
798	Xhamia në Tygjec	1890	Tyxhec, Kamenicë		270
799	Shtëpia e Rexhep Berishës		Svircë, Kamenicë		4253


Në listën e Ministrisë figurojnë edhe këto objekte, të shënuara me fusnotë, që nënkuptojnë se këto objekte janë shkatërruar me kohë ose kanë probleme tjera (si p.sh. nuk vërtetohet se i përkasin personalitetit të cilit i referohen):

- Shtëpia e Sylë Haskut, Kremenatë (810)
- Shtëpia e Hamdi Demollit, Krilevë (825)
- Kulla e Tahir Gagices, Velegllavë (848)
- Shtëpia e Lot Vakut, Polickë (842)

Gjithashtu në këtë listë figurojnë edhe katër objekte të luajtshme:

- Stelë (137)
- Dorezë kocke (182)
- Vegël mjeksore (184)
- Tavani i shtëpisë së Ilmi Murselit (204)

### Biblioteka e Qytetit



#### Foto e Bibliotekës së Qytetit në Kamenicë

Në Bibliotekën e Qytetit gjejmë rreth 10.000 tituj librash, në mbi 25.000 ekzemplarë. Numri i lexuesve aktiv të regjistruar është rreth 370. Përveç huazimit të librave, lexuesit mund të shfrytëzojnë edhe sallën e leximit për të rritur me rreth 20 tavolina leximi, si dhe këndin e leximit për fëmijë. Poashtu në Bibliotekën e Qytetit organizohen takime letrare, konkurse letrare, promovime librash etj.

## Arkivi Historik Komunal



### Foto e Arkivit Komunal në Kamenicë

Arkivi Historik i Kamenicës funksionon në kuadër të DKRS-së dhe është i vendosur në dy depo në bodrumet e Shtëpisë së Kulturës “Isa Kastrati”, dhe ka një sasi të dokumentacionit prej më shumë se 120 metrash gjatësi. Dosjet janë të vendosura në rafte të metalta dhe në kushte të mira.

Përveq sektorëve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport menaxhon edhe me objekte e hapësira të ndryshme si:

- Shtëpia e Kulturës “Isa Kastrati”, Teatri, Kinemaja, Këndi Muzeor, Galeria, Qendra Rinore “Fanak” Salla e Baletit, Kabineti i teknologjisë së informacionit, Ateleja e piktorëve, Këndi i lojrave, Salla e trajnimeve, Zyre për takime, Biblioteka e Qytetit, Salla e Leximit, Këndi i fëmijëve, hapësira për takime letrare, promovime etj.

Po ashtu edhe Arkivi Historik Komunal, Arkivi Kadastral (DPKGj), Salla e Konferencave, “BONEVET” Shkolla e Muzikës, Amfiteatri, Palestra Sportive, Stadiumi i Qytetit “Agush Isufi”.

Vlen të theksohet se nga viti 2019 deri në vitin 2021, Shtëpia e Kulturës “Isa Kastrati” i është nënshtruar një sërë renovimesh duke përfshirë ndërrimin e dritareve, izolimin dhe fasadimin e jashtëm, drenazhimin, renovimi i brendshëm dhe riinventarimi i zyreve, bibliotekës, arkivit, qendrës rinore si dhe instalimi i sistemit modern kinematografik, ndërsa punime janë kryer edhe në Stadiumin e Qytetit “Agush Isufi”, ku në vitin 2018 janë përruruar objekti i ri i zhyeshitoreve, sistemi i ujitjes, shtegu i atletikës, tribunat e revonuara bashkë me ulëse etj. Në gjendje të mirë është edhe Palestra Sportive e cila ka filluar të shfrytëzohet prej vitit 2017 ndërsa në vitin 2019 është investuar në riparimin e çatisë.

## EKONOMIA

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë është kompetente në këtë fushë, sidomos për ndërtimin e kapaciteteve ekonomike të zonës lokale për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët, duke krijuar kushte të favorshme për bizneset lokale, duke promovuar potencialet për zhvillimin e turizmit dhe njëherit duke pasur një Diasporë shumë të fuqishme e cila mund të shërbejë në krijimin e urave lidhëse, përmes investimeve të Diasporës, me komunën dhe qytetarët e saj.

Ekonomia e komunës sonë pati një zhvillim në vitet 1970-1990, sidomos industria dhe tregtia. Industria në komunë është bazuar kryesisht në eksploatimin dhe në përpunimin e pasurive minerale, sepse për këto resurse në të kaluarën janë ngritur kapacitete prodhuese, gjë që ka bërë të mundur edhe rritjen e numrit të vendeve të punës për qytetarët.

Ndërmarrjet e tilla kryesisht kanë qenë të sektorit shoqëror, prandaj edhe sot investimi dhe riaktivizimi në zhvillimin e industrisë për përpunimin e mineraleve (metaleve dhe jo metaleve), të materialit ndërtimor dhe ndërtimtarisë konsiderohen akoma potencial i mirë zhvillimor për të rritur zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e vendeve të punës në komunë, sepse nevojat për punësim sot janë të larta, edhe pse në këtë fazë duket e vështirë të jetë e realizueshme, por komuna duhet ta ketë parasysh faktin që në periudhën strategjike të ketë synim që me partnerë ose me donatorë potencialë të fillojë investimet edhe në këtë fushë.

Nga pasuritë minerale që ekzistojnë në komunë janë: kaolini, magneziti, andeziti, betoniti, kuarci, hekuri, rëra, tufi etj, dhe konsiderohet se rezervat i sigurojnë komunës një eksploatim të gjatë të këtyre pasurive, por është e evidente se nevojiten investime kapitale të mëdha e të cilat aktualisht komuna nuk i ka.

Bshkëpunimi në mes sektorit të zhvillimit ekonomik dhe sektorit të bujqësisë duhet të intensifikohet për ti shtuar kapacitetet prodhuese, përpunuese dhe shërbyese.

**Tabela 29. Resurset minerale në komunë**

Nr.	Xehet	Sasia	Nr.	Xehet	Sasia
1	Magneziti	1.3 mil/t	8	Tufi	665.000/ t
2	Andeziti	635.000/m <sup>3</sup>	9	Deltina	30.000/ m <sup>3</sup>
3	Kaolini	3.5 mil/t	10	Gëlqerori	250.000/ m <sup>3</sup>
4	Betoniti	1.2 mil/t	11	Graniti	1.800/t
5	Kuarci	2.5 mil/t	12	Feldspati	50.000/ t
6	Rëra	200.000/m <sup>3</sup>	13	Zhavori	60.000/ t
7	Hekuri	50.000 /t			

Burimi: SZHEL 2007-2010

## Të dhëna statistikore për biznese

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë duke parë që numri i bizneseve të regjistruara në Komunën e Kamenicës nga viti 2000 e tutje është shumë i lartë, dhe nuk përkon me numrin e bizneseve që realisht operojnë në të gjithë territorin e komunës, në vitin 2018 ka ndërmarrë një iniciativë për identifikimin e bizneseve aktive.

Procesi i identifikimit të bizneseve ka marrë kohë pasi që janë verifikuar bizneset direkt në terren, dhe janë mbledhë të dhëna të shumta për biznese.

Përmes këtij procesi është arritë të:

- Krijohet një databazë me të dhëna të sakta për bizneset aktive;
- Klasifikohen bizneset në bazë të veprimtarive;
- Të identifikohet numri real i vendeve të punës;
- Identifikohen problematikat e bizneseve.

**Tabela 30. Raporti i bizneseve të regjistruara dhe aktive**

Periudha	Biznese të regjistruara	Biznese aktive
2000-2018	2213	817
2000-2022	2621	1032

Sic shihet në tabelë, raporti i bizneseve të regjistruara dhe atyre aktive nuk është në përputhje për periudhën e njejtë të raportimit. Burimi i të dhënave për bizneset e regjistruara është Agjensia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë – ARBK, e cila ka databazën e të dhënave për bizneset e regjistruara që nga viti 2000 e tutje. Këto të dhëna azhurohen nga ARBK dhe janë të dhëna zyrtare.

Burimi i të dhënave për bizneset aktive është Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë e cila ka databazën e të dhënave të bizneseve aktive pas procesit të identifikimit të bizneseve, pra që nga viti 2019 dhe kjo databazë azhurohet nga kjo drejtori.

**Tabela 31. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektoreve 2000-2018**


Sektorët	Biznese të regjistruara	Biznese aktive
A - Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	237	83
B- Xeheroret dhe gurëthyesit	33	1
C- Industria përpunuese	196	78
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	0	0
E- Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	5	0
F- Ndërtimtaria	189	50
G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	781	278

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

H- Transporti dhe magazinimi	290	120
I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	164	65
J- Informimi dhe komunikimi	37	6
K- Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	9	6
L- Aktivitetet e patundshmërive	1	0
M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	47	17
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	35	10
O- Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi social	1	0
P- Arsimi	14	7
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	21	16
R- Arte, argëtimi dhe rekreimi	39	10
S- Aktivitetet tjera shërbyese	113	70
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallëra të padiferencuara- dhe shërbime- aktivitetet prodhuese të ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	1	0
U- Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>2213</b>	<b>817</b>

Në tabelë është paraqitur ndarja e bizneseve në bazë të sektorëve për periudhën 2000-2018 ku shihet që ka mospërputhje mes bizneseve të regjistruara dhe atyre aktive për sektorë të caktuar, secili sektor ka më shumë biznese të regjistruara se sa janë realisht aktive.

Grafiku 15. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektoreve 2000-2018



## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

**Tabela 32. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektoreve 2000-2022**

Sektorët	Biznese te regjistruara	Biznese aktive
A -Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	305	110
B- Xehoret dhe gurëthyesit	34	2
C- Industria përpunuese	248	122
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	0	1
E- Furnizimi me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	5	0
F- Ndërtimtaria	228	91
G-Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	870	320
H-Transporti dhe magazinimi	309	93
I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	205	86
J- Informimi dhe komunikimi	50	15
K- Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	16	10
L- Aktivitetet e patundshmërive	2	1
M-Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	61	28
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	51	23
O- Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ	1	0
P- Arsimi	17	12
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	28	19
R- Arte, argëtimi dhe rekreimi	51	21
S- Aktivitetet tjera shërbyese	139	78
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallëra të padiferencuara- dhe shërbime- aktivitetet prodhuese te ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	1	0
U- Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0	0
	<b>2621</b>	<b>1032</b>

Në tabelë është paraqitur ndarja e bizneseve në bazë të sektorëve për periudhën 2000-2022 dhe shihet që ka mospërputhje mes bizneseve të regjistruara dhe atyre aktive për sektorë të caktuar, secili sektor ka më shumë biznese të regjistruara se sa janë realisht aktive

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Grafiku 16. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të sektoreve 2000-2022




Tabela 33. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimtarive 2000-2018

Veprimtaria	Biznese të regjistruara		Biznese aktive	
	Nr. bizneseve	Përqindja %	Nr. bizneseve	Përqindja %
Prodhuese	471	21.28%	162	19.82%
Shërbyese	772	34.88%	327	40.02%
Tregtare	781	35.29%	278	34.02%
Ndërtimore	189	8.54%	50	6.11%
	<b>2213</b>	<b>100%</b>	<b>817</b>	<b>100%</b>

Në tabelë është paraqitur ndarja e bizneseve në bazë të veprimtarive për periudhën 2000-2018 dhe shihet që përqindjen më të lartë e kanë bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari tregtare dhe shërbyese pastaj ato prodhuese e në fund janë bizneset ndërtimore.

Grafiku17. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimtarive 2000-2018






Tabela 34. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimtarive 2000-2022

Veprimtaria	Biznese të regjistruara		Biznese aktive	
	Nr. bizneseve	Përqindja %	Nr. bizneseve	Përqindja %
Prodhuese	592	22.58%	235	22.77%
Shërbyese	931	35.52%	386	37.40%
Tregtare	870	33.19%	320	31%
Ndërtimore	228	8.69%	91	8.81%
	<b>2621</b>	<b>100%</b>	<b>1032</b>	<b>100%</b>

Në tabelë është paraqitur ndarja e bizneseve në bazë të veprimtarive për periudhën 2000-2022, dhe shihet që përqindjen më të lartë e kanë bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari shërbyese, dhe tregtare pastaj ato prodhuese e në fund janë bizneset ndërtimore.

Grafiku 18. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të veprimtarive 2000-2022




Tabela 35. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë 2000-2018

Gjinia	Biznese të regjistruara		Biznese aktive	
	Nr.bizneseve	Perqindja	Nr.bizneseve	Perqindja
Meshkuj (M)	1852	83.68%	678	82.98%
Femra (F)	361	16.31%	139	17.01%
	<b>2213</b>	<b>100%</b>	<b>817</b>	<b>100%</b>

## STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Në tabelë është paraqitur ndarja e bizneseve në bazë të gjinisë për periudhën 2000-2018, dhe shihet që përqindje dukshëm më të lartë kanë bizneset të cilat janë në pronësi të meshkujve në krahasim me bizneset që janë në pronësi të grave.

Grafiku 19. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë 2000-2018




Tabela 36. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë 2000-2022

Gjinia	Biznese të regjistruara		Biznese aktive	
	Nr.bizneseve	Përqindja	Nr.bizneseve	Përqindja
Meshkuj (M)	2154	82.18%	845	81.87%
Femra (F)	467	17.81%	187	18.12%
	<b>2621</b>	<b>100%</b>	<b>1032</b>	<b>100%</b>

Në tabelë është paraqitur ndarja e bizneseve në bazë të gjinisë për periudhën 2000-2022, dhe shihet që përqindje dukshëm më të lartë kanë bizneset të cilat janë në pronësi të meshkujve në krahasim me bizneset që janë në pronësi të grave.

Grafiku 20. Ndarja e bizneseve të regjistruara dhe aktive në bazë të gjinisë 2000-2022




Tabela 37. Krahasimi i bizneseve të regjistruara dhe të shuara mes vitit 2020 dhe 2021

Viti	Nr. bizneseve të regjistruara	Nr. bizneseve të shuara
2020	134	36
2021	98	32

Në tabelë është paraqitur krahasimi i bizneseve të regjistruara dhe atyre të shuara ku janë marrë për krahasim vitet 2020 dhe 2021, dhe shihet që në vitin 2020 kemi numër më të lartë të bizneseve të regjistruara se sa në vitin 2021, pra kemi një trend të zvoglimit të numrit të bizneseve të regjistruara, ndërsa sa i përket numrit të bizneseve të shuara kemi pothuajse numër të njëjtë për të dy vitet.

**BUJQËSIA-** Nga sipërfaqja e përgjithshme e Komunës së Kamenicës 58 % prej tyre janë tokë bujqësore, kurse 42 % janë sipërfaqe pyjore. Bujqësia në komunën tonë është sektori më i rëndësishëm, pasi që pjesa më e madhe e popullatës së komunës sonë është e angazhuar në këtë sektor. Gjendja e bujqësisë në komunën tonë karakterizohet me ferma të vogla, dhe mesatare 2.2 - 2.4 ha, të shpërndarë në 7 - 8 ngastra për fermë. Me prodhimtari nën mesatare të rajonit, pa mbështetje profesionale. Mbi 70 % e popullatës jeton në zonat rurale, dhe ekskluzivisht merren me bujqësi dhe pylltari.

Me themelimin e DBPZHR, në bashkëpunim me MBPZHR dhe shoqatave të huaja, u ndihmohet fermerëve në mbështetje materiale dhe profesionale

Objektivat kryesore në planin afatmesëm janë:

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe ruajtja e saj nga ndërtimet e planifikuara dhe ristrukturimit të fermës;  
Rritja e produktivitetit në fermë dhe aftësisë konkurse që do të arrihet përmes ngritjes së të ardhurave në fermë, përmirësimit të jetës në viset rurale, përmirësimit të aftësive konkurse, zvogëlimit të importit të produkteve bujqësore dhe shtimit të eksportit, krijimit të mundësive në punësim në zonat rurale, aplikimi i standardeve të BE, përmirësimi i pyjeve përmes ruajtjes së pyjeve, pyllëzimit, rregullimit të sipërfaqeve të degraduara, ndërmarrja e masave në infrastrukturën pyjore , hartimin e planeve menaxhuese.

Territori i Komunës së Kamenicës shtrihet në një sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup>, me rreth 36,085 banorë rezident sipas regjistrimit të popullsisë nga viti 2011, të grupuar në 58 fshatra. Numri i ekonomive familjare-bujqësore sillen rreth 3,500.

Nga e gjithë sipërfaqja e cekur më lartë, sipërfaqe tokë bujqësore dhe tokë pyjore janë 22.770 ha, (Ara 15.338 ha, Kullosa 7,432 ha.), 58 % dhe pyje 16,591.80 ha. ose 42 %.

**Tabela 38. siperfaqet buqësore**

Nr.	Emërtimi i tokave	Sipërfaqja në /ha.
1	Tokë e punushme – Ara	12,284
2	Pemë dhe Perime	rreth 500
3	Livadhet	2,897
4	Kullosa	7,432
5	Pyje	16,591

Madhësitë mesatare të fermave janë 2.2 - 2.4 ha. për familje, të ndara në 6-8 ngastra, fermat janë kryesisht të vogla dhe gjysmë komerciale.

Madhësia e fermës në Komunën e Kamenicës, por edhe e Kosovës është për disa herë më e vogël se ajo që është në nivelin e Bashkësisë Evropiane. Prona mesatare në BE në vitin 1997 ishte 18.4 ha. me variacione në mes 4.3 ha. në Greqi dhe 69.3 ha. në Britaninë e Madhe.

Më tepër se 60 % të popullsisë jetojnë në zonat rurale, ku në Komunën e Kamenicës mendohet se janë rreth 3,500 ekonomi familjare që merren me bujqësi.

**CILËSIA E TOKËS** – Vlerësohet si e ndryshueshme si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve gjeologjik. Sipas bonitetit, toka e punueshme është e klasifikuar në 8 klasa. Zakonisht, 5 klasat e para përdoren në prodhimtarinë bujqësore. Tokat e klasës I dhe II, me 500 ha, bëjnë pjesë në ato më pjelloret, me aftësi të larta prodhuese. Tokat e klasës së III, me 2,400 ha, janë ende toka të mira për punim dhe shfrytëzim, por për nga pjelloria ngecin nga dy të parat.

Tokat e këtij grupi kërkojnë disa përmirësime për t'u kthyer në toka me aftësi të lartë produktiviteti. Tokat e klasës së IV, me 6,300 ha, karakterizohen me aftësi të kufizuara pjellore, si toka të cekëta dhe me përmbajtje të lartë të rërës.

Duhet pasur kujdes që gjatë shfrytëzimit të tokës duhet të sigurohet mbrojtja dhe kultivimi i drejtë, në mënyrë që të evitohet degradimi i substratit prodhues. Po ashtu, duhet të pengohet ndërrimi i pa kontrolluar i destinimit të tokës bujqësore dhe ndotja e tokës bujqësore.

Në Komunën e Kamenicës tokat bujqësore kanë humbur në forma të ndryshme që mund të rangohen në disa mënyra.

Humbjet e tokës janë kryesisht nga ndërtimi i vendbnimeve, veprimtarive komerciale, industria dhe komunikacioni.

### Humbjet e përkohshme të tokës

Në tabelën si më poshtë, janë të paraqitura humbjet e përkohshme të tokës

**Tabela 39. Humbjet e përkohshme të tokës**

Nr.	Lloji i humbjeve
1	Mihjet sipërfaqësore;
2	Eksplotimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës;
3	Hedhurinat e automjeteve (deponitë);
4	Mbeturinat industriale;
5	Mbeturinat komunale;
6	Procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve etj.


Në mbjelljet vjeshtore toka kryesisht mbillet me grurë, për derisa në mbjelljet pranverore me misër dhe bimë foragjere .

### Lavërtaria - Prodhimtaria bujqësore

Sa i përket sektorit të lavërtarisë në komunën tonë kemi kultivimin e këtyre llojeve të drithërave si:

Tabela 40. Llojet e drithrave

Nr.	Lloji i Drithërave	Sipërfaqja në / ha.
1	Kultivimi i Grurit	mbi 2000
2	Kultivimi i Misrit	rreth 1200
3	Kultivimi i Elbit	100
4	Kultivimi i Tërshères	150
5	Kultivimi i Thekrës	10



### Sektori i Blegtorisë

Zhvillimi i blegtorisë në vend është në varshmëri nga trendet e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Vlerësohet se inputet me të cilat disponon vendi janë potencial i mjaftueshëm për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale, në nivel të krahasueshëm me vendet e regjionit.

Trendet aktuale të zhvillimit të blegtorisë në vend varen nga investimet e kapitalit individual në ngritjen e objekteve të reja, dhe sipas vlerësimit të gjendjes aktuale

#### Kullosat me bagëti në Karaçevë të epërme

në terren. Zhvillimet në blegtori janë të rregulluara me Ligjin e Blegtorisë së Kosovës dhe Strategjinë Zhvillimore 10 vjeçare.

Sa i përket sektorit të blegtorisë në komunën tonë kemi kultivimin e këtyre llojeve të kafshëve si:

Tabela 41. Kultivimi i llojeve të kafshëve

Nr.	Lloji i Kafshëve	Numri i Krerëve
1	Kultivimi i lopëve qumështore	3000
2	Kultivimi i mëshqerrave	500
3	Kultivimi i viçave për majmëri / trashje	400
4	Kultivimi i deleve qumështore	4,500
5	Kultivimi i qengjave	5,000
6	Kultivimi dhive qumështore	700
7	Kultivimi i kecave	900
8	Kultivimi dosave	500
9	Kultivimi gicave	1,500
10	Kultivimi i kuajve	50
11	Kultivimi i bletëve	9000
12	Kultivimi i shpezëve	55,000

Prej këtyre llojeve të kafshëve, më së shumti kultivohen lopë qumështore të llojit Laramanja e vendit, Sientali, Hollshtajni etj. dhe majmëria e viçave për trashje.

Bazat për hartimin e politikës blegtorale janë cekur në Librin e Gjellbërt të Ministrisë, përmes së cilit synohet zhvillimi i politikës me një qasje pjesëmarrëse. Kjo d.m.th. këshillim/diskutim me, OJQ-të që veprojnë në këtë sektor, dhe organizatat e fermerëve, përpunuesit dhe tregtarët. Politikat e përgjithshme janë parashtruar në kapitullin II të Librit të Gjellbërt.

Synim kryesor i qeverisjes komunale në aspektin afat shkurtër-mesëm është që të krijoj vende pune, dhe të ngritë të ardhurat e fermerëve të varfër të ekonomive të vogla bujqësore; të ndihmojnë në zgjerimin e aktiviteteve, njëkohësisht këto politika do të promovonin lëvizjet drejt komercializimit më të madh.

Është e nevojshme që të bëhet e ditur nevoja për të barazpeshuar kërkesat “sociale” për të ndihmuar fermerët e vegjël dhe kërkesat “zhvillimore”, për inkurajimin e njësive më të mëdha komerciale të veprimtarisë bujqësore dhe njësive agro-përpunuese.



**Sektori i Perimkulturës-** Kulturat perimëtare kultivohen në një sipërfaqe mbi 200 ha. (spec, domate, patate, shalqi etj. ) të cilat kultivohen në fushë të hapur dhe në serra. Në serra kultivohen; speci, domatja, trangulli, lakra, qepujka, llojet e sallatave të gjellbërta.

Sa i përket perimeve po ashtu ka tendencë në ngritjen e mini-serrave, pasi që shfrytëzohet në mënyrë më racionale sipërfaqja e tokës sepse ka

kushte klimatike, tokësore dhe përvoja në këto kultura dhe mund të arrihen rezultate konkurruese në treg. Në të ardhmen do të ndihmojmë në shtimin e sipërfaqeve me serra.

Sa i përket sektorit të perimtarisë, në komunën tonë kemi kultivimin e këtyre llojeve të perimeve:

**Tabela 42. Kultivimi i perimeve**

Nr.	Lloji i Perimeve	Sipërfaqja në / ha.
1	Kultivimi i specit	50
2	Kultivimi i domates	20
3	Kultivimi i patates	50
4	Kultivimi i trangujve	2
5	Kultivimi i qepës	15
6	Kultivimi i hudhrës	2
7	Kultivimi i lakrës	8
8	Kultivimi i shalqinit	50
9	Kultivimi i pjeprës	5
10	Kultivimi i kungullit dhe kungullit të misirit	30

Prej këtyre llojeve të perimeve, më së shumti kultivohen speci, domatja, patatja, shalqini. Në sektorin e perimeve viteve të fundit kemi rritje të sipërfaqeve të mbjellura me kunguj të misirit, edhe ate kanë ndikuar këtu aplikimet për pagesa – direkte për subvencione dhe grante nga Ministria e Bujqësisë.



**Sektori i pemëtarisë** – Pemët kultivohen në një sipërfaqe mbi 250 ha, (mollë, kumbull, dardhë, arra, lajthi) etj. Prej kulturave dominante janë molla dhe kumbulla, por vlen të ceket se kemi edhe shtim të arrës dhe lajthisë.

Viteve të fundit ka tendencë të rriten sipërfaqet me pemë ku brenda mandatit do të dyfishohet kjo sipërfaqe, por për realizimin e këtyre tendencave duhet investuar në kapacitetet

përpunuese të pemëve.

Në të ardhmen do të ndihmojmë në ngritjen e pemishteve dhe në infrastrukturë të këtyre pemishteve.

Sa i përket sektorit të pemëtarisë në komunën tonë kemi kultivimin e këtyre llojeve të pemëve si:

**Tabela 43. Siperfaqet e mbjella me pemë**

Nr.	Lloji i Pemëve	Sipërfaqja në /ha.
1	Kultivimi i Mollës	100
2	Kultivimi i Dardhës	15
3	Kultivimi i Kumbullës	50
4	Kultivimi i Arrës	80
5	Kultivimi i Lajthisë	12
6	Kultivimi i pemëve të imëta ( manore )	10

Prej këtyre llojeve të pemëve, më së shumti kultivohen molla, kumbulla dhe arra. Në sektorin e pemëve viteve të fundit kemi rritje të sipërfaqeve të mbjellura me arra dhe lajthi, këtu kanë ndikuar aplikimi për pagesa – direkte për subvencione dhe grante nga Ministria e Bujqësisë. Vlen të theksohet se kemi shtim edhe të sipërfaqeve me bimë mjekuese aromatike.



**Zhvillimi rural**- Zhvillimi rural është një proces në të cilin popullata rurale (individët, ekonomitë familjare dhe komuniteti) i bashkojnë resurset e tyre dhe i përmirësojnë kushtet e tyre të jetës dhe punës, përmes zhvillimit të aftësive të tyre, rritjes së aftësive të tyre analitike dhe kërkuese, dhe duke formuar organizatat e komunitetit, që do të rezultonte në përmirësimin e të ardhurave të tyre, përmirësimin e shëndetit, edukimit, infrastrukturës dhe shërbimeve sociale.

Së fundi, banorëve të zonave rurale u jepet mundësia që të kontribuojnë për lirinë civile, të menaxhojnë vet zhvillimin e tyre, me marrëdhënie të balancuara gjinore dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve ambientale lokale.

Qasja bashkëkohore lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm rural nënkupton një qasje komplekse e cila përfshinë: bujqësinë, resurset nacionale dhe menaxhimin e tyre, transportin rural, ujin dhe higjienën, telekomunikimet, edukimin, shëndetësinë, shërbimet sociale.

Zhvillimi rural në Komunën e Kamenicës përballlet me shumë probleme specifike: standardi i ulët i popullsisë rurale, shkalla e ulët e arsimimit në zonat rurale, infrastruktura e dobët, niveli i ulët i prodhimit bujqësor, dhe rritja e ngadalshme ekonomike me një bazë të gjerë.

### **Infrastruktura rurale, shfrytëzimi i resurseve në zonat kodrinoro-malore dhe zhvillimi i turizmit rural**

Komuna e Kamenicës është e ndarë në 58 fshatra. Krijimi i një infrastrukture të përshtatshme mund të konsiderohet si një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin rural në Kamenicë. Përmirësimi i përgjithshëm i kushteve të jetesës mund të arrihet vetëm me një infrastrukturë rurale të zhvilluar, por jo vetëm kaq, infrastruktura rurale është edhe parakusht esencial për rritjen e prodhimtarisë bujqësore, rritjes së aftësive konkurruese, si dhe rritjen e profitabilitetit dhe në përgjithësi krijimin më të madh të të hyrave, që ndikojnë në rritjen e standardit jetësor.

Duke e zhvilluar infrastrukturën në komunë, përmirësimin e kushteve të jetesës në përgjithësi do të pengojë edhe fenomenin e migrimit të popullatës nga zonat rurale drejt atyre urbane.

**Sektori i Pylltarisë-** Në tabelën si më poshtë janë të paraqitura sipërfaqet e pyjeve publike dhe private:

**Tabela 44. Sipërfaqet me pyje sipas pronësisë**

Nr.	Emërtimi i Pyjeve	Sipërfaqja në / ha.
1	Pyje Private	9,623
2	Pyje Publike	9,118
	Gjithsej	18,741

Sektori i pylltarisë, ngjashëm me sektorët tjerë për kohë të gjatë është ballafaquar me probleme dhe sfida të shumta, shumë prej të cilave nuk janë zgjidhur deri në këtë kohë. Pyjet dhe resurset pyjore me pjesëmarrjen e tyre afro 41.2% në sipërfaqen e përgjithshme të Komunës së Kamenicës kanë rëndësi të madhe ekologjike, sociale, shëndetësore dhe ekonomike.

Struktura pyjore ekzistuese, sasia e sipërfaqeve të zhveshura, nevoja e shpalljes së zonave të mbrojtura, nevoja e ruajtjes së tokave pyjore, zhvillimi i infrastrukturës pyjore, ndërrimi i destinimit të tokave pyjore etj. imponojnë qasje serioze të trajtimit të këtij sektori si komponent e rëndësishme e planifikimit hapësinor.


Sipërfaqja e tërësishme e mbuluar me pyje në Komunën e Kamenicës është afërsisht rreth 18,741 ha, që i përgjigjet 41.2% të sipërfaqes së tërësishme të Komunës së Kamenicës.

Prej tyre rreth 9,623 ha. janë pyje private ndërsa 9,118 ha janë pyje publike - shtetërore.

**Tabela 45. Sipërfaqet me pyje**

Nr	Emërtimi i Pyjeve	Perqindja %.
1	Pyjet e ulëta (cungishte), përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqes pyjore	40%
2	Pyje të larta (trungishte)	31%
3	Kultura pyjore	2%
4	Toka pyjore	6%
5	Të tjerat janë klasifikuar si pyje të degraduara dhe shkurre	21%

**Grafiku 21. Sipërfaqet me pyje**



Pyjet e ulëta (cungishte), përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqes duke mbuluar kështu më se 40% të zonës pyjore.

Rreth ( 31 %) vlerësohen si pyje të larta (trungishte), kultura pyjore 2%, ndërsa të tjerat janë klasifikuar si të degraduara dhe shkurre apo 21% prej tyre.

Përveç këtyre zonave, ekzistojnë toka pyjore rreth 1,093 ha ose 6 %.

Masa drunore e përgjithshme në pyjet shoqërore është vlerësuar rreth 942.092 m<sup>3</sup>, po aq supozohet edhe në sektorin privat. Etati vjetor në bazë të parametrave sillet rreth 56.220 m<sup>3</sup>.me rreth 2.2 m<sup>3</sup>/ha. Në pylltari duhet të mirren masa restauruese, në mënyrë që të jenë produktive. Rreth 1,853 ha klasifikohen si shkurre, dhe toka të varfëra, të cilat duhet pyllëzuar.

Për nga shtrirja hapësinore llojet kryesore drunore në Komunën e Kamenicës janë: dushku dhe ahu . Llojet (speciet) tjera drunore janë: frashëri, shkoza, lajthia, plepi, shelgu etj.

**BUXHETI KOMUNAL-** Nëse i bëjmë një analizë buxhetit të komunës, shohim se ekziston një dallim i madh i potencialit ekonomik të komunës për të gjeneruar të hyra. Buxheti i komunës për vitin fiskal 2022 është 11,070,592.00€, dhe planifikimi i pjesëmarrjes së të hyrave vetjake (THV) 883,430.00€ është e ulët në raport me Grantin Qeveritar(GQ) 10,187,162.00€. Pra shihet se burimet e financimit të buxhetit të komunës janë kryesisht: Granti i përgjithshëm, Granti i Arsimit, Granti Specifik në Shëndetësi, Grantet e donatorëve të jashtëm e të mbrendshëm dhe huamarrja komunale.

Tabela 46. Burimet e financimit në Komunën e Kamenicës (€), periudha 2022-2025

Burimi i të hyrave	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi
	2022	2023	2024	2025
<b>Granti I përgjithshëm</b>	4,071,728.00	5,360,529.00	5,744,369.00	6,119,851.00
<b>Granti I Arsimit</b>	4,659,800.00	4,483,745.00	4,676,318.00	4,688,580.00
<b>Granti I shëndetsisë</b>	1,278,384.00	1,397,854.00	1,467,747.00	1,541,134.00
<b>Sherbimet sociale Rezid.</b>	177,250.00	183,000.00	185,000.00	185,000.00
<b>Gjithësej Grantet</b>	<b>10,187,162.00</b>	<b>11,425,128.00</b>	<b>12,073,434.00</b>	<b>12,534,565.00</b>
<b>Të hyrat vetanake</b>	<b>883,430.00</b>	<b>956,771.00</b>	<b>995,593.00</b>	<b>1,037,707.00</b>
<b>GJITHËSEJ BUXHETI</b>	<b>11,070,592.00</b>	<b>12,381,899.00</b>	<b>13,069,027.00</b>	<b>13,572,272.00</b>

Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mblidhen nga tatimi në pronë, taksat, tarifrat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkë-pagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj.

Komunat pranojnë grante operative nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës sipas formulës për shpërndarjen e Granteve operative që janë: Grantet e Përgjithshme, Grantet Specifike për Arsim dhe Grantet Specifike për Shëndetësi.


Në vitin 2022, gjithsej granti qeveritar për Komunën e Kamenicës ishte: **10,187,162.00€**.

Ndërsa të hyrat vetanake janë: **883,430.00€**.

Prej tyre Granti i Përgjithshëm: **4,071,728.00€**, Granti i Arsimit: **4,659,800.00€**, Granti i Shëndetsisë: **1,278,384.00€** dhe Granti i Shërbimeve Sociale Rezidenciale: **177,250.00€**.

Komuna duhet të krijoj edhe të hyra tjera si taksë rrjedhëse për të rritur burimet e financimit nga burimet vetanake

Graf. 20 Mesatarja e burimeve të financimit në Komunën e Kamenicës (%), për vitin 2022



Bazuar në të dhënat e tabelës më lartë kemi kalkuluar mesataren e grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake për periudhën 2022, dhe ka rezultuar si në vijim: mesatarisht 92% e buxhetit të Komunës së Kamenicës bazohet në grantin qeveritar, dhe mesatarisht 8% në të hyrat vetanake. Ky rezultat vë në pah se komuna varet kryesisht prej fondeve qeveritare, dhe se kapacitetet e komunës thuhet janë të kufizuara për shkak të arkëtimit të kufizuar të të hyrave vetanake.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027

Tabela 47. Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal 2021-2024

Nr.	Përshkrimi	2021Buxheti	2022Buxheti	2023Vlerësimi	2024Vlerësimi
a	b	g	g	g	g
<b>1.1</b>	<b>TË HYRAT VETANAKE</b>	<b>800,459.00</b>	<b>883,430.00</b>	<b>956,521.00</b>	<b>999,540.00</b>
	<b>Tatim ne pronë dhe tokë</b>	<b>339,325.00</b>	<b>502,648.00</b>	<b>564,316.00</b>	<b>595,969.00</b>
1.1.1	<b>Tatimi në pronë</b>	<b>204,693.00</b>			
	<b>Tatimi në Tokë</b>	<b>134,632.00</b>			
1.1.2	<b>Taksat komunale</b>	<b>255,754.00</b>	<b>222,754.00</b>	<b>208,766.00</b>	<b>234,518.00</b>
	Licencat dhe lejet	3,000.00	3,000.00	5,000.00	5,000.00
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	133,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00
	Taksat e pajisjeve motorike	63,000.00	63,000.00	63,500.00	63,800.00
	Lejet për ndërtesa	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
	Taksat tjera komunale	36,754.00	36,754.00	20,266.00	45,718.00
1.1.3	<b>Ngarkesat komunale</b>	<b>128,500.00</b>	<b>128,500.00</b>	<b>130,000.00</b>	<b>131,500.00</b>
	Të hyrat nga qiraja	40,000.00	40,000.00	41,000.00	42,000.00
	Bashkë-pagesat për arsim	19,000.00	19,000.00	19,500.00	20,000.00
	Bashkë-pagesat për shëndetësi	45,000.00	45,000.00	45,000.00	45,000.00
	Ngarkesat tjera komunale	24,500.00	24,500.00	24,500.00	24,500.00
1.1.4	<b>Të hyrat tjera</b>	<b>72,880.00</b>	<b>25,528.00</b>	<b>49,439.00</b>	<b>33,553.00</b>
1.1.5	<b>Shitja e asetëve</b>	<b>4,000.00</b>	<b>4,000.00</b>	<b>4,000.00</b>	<b>4,000.00</b>
1.1.6	<b>Grantet dhe donacionet</b>				

Burimi: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kamenicës 2023-2025


**Struktura e shpenzimeve-** Struktura e shpenzimeve: siç shihet në tabelat në vijim, shpenzimet rrjedhëse përbëjnë 90.02% të shpenzimeve komunale dhe ato kapitale vetëm 9.98%. Nga shpenzimet rrjedhëse, më të lartat janë ato për paga dhe mëditje 69.03%, pastaj shpenzimet për mallra dhe shërbime 15.98%, subvencionet 1.91% dhe shpenzimet komunale 3.10%

**Tabela 48.Struktura e shpenzimeve në Komunën e Kamenicës (€), viti 2022**

Struktura e shpenzimeve	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi
	2022	2023	2024	2025
Paga dhe meditja	7,642,413.00	7,566,476.00	7,604,308.00	7,642,330.00
Mallra dhe shërbime	1,769,200.00	1,943,000.00	2,005,300.00	2,058,300.00
Shpenzime komunale	211,800.00	238,000.00	245,000.00	255,000.00
Subvencione	343,000.00	447,000.00	542,000.00	557,000.00
Investime Kapitale	1,104,179.00	2,187,423.00	2,672,417.00	3,059,643.00
<b>TOTALI</b>	<b>11,070,592.00</b>	<b>12,381,899.00</b>	<b>13,069,025.00</b>	<b>13,572,273.00</b>

Graffiku 22. Struktura e shpenzimeve

Struktura e shpenzimeve në Komunën e Kamenicës (%), viti 2022



Burimi: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kamenicës 2023-2025




### 3. ANALIZA SWOT

Për të marrë një vendim të rëndësishëm zhvillimor komunal, kërkohet një analizë dhe një rishikim gjithëpërfshirës të faktorëve që kontribuojnë direkt ose indirekt, ose që e pengojnë këtë zhvillim. Prandaj një nga veprimet për të siguruar besueshmërinë e aktiviteteve, planeve dhe programeve strategjike për zhvillimin e komunave është analiza SWOT.

Në këtë drejtim, analiza SWOT ka mjaft rëndësi ngase vepron si një mjet për marrjen e vendimeve nga qeverisjet komunale mbi zbatimin e strategjive të investimeve në komunë.

Analiza SWOT është gjithëpërfshirëse dhe një analizë në detaje e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm. Mjedisit i jashtëm i komunës është një analizë e mundësive “O” dhe rreziqeve “T”, që dalin nga mjedisit i jashtëm i komunës. Mjedisit i brendshëm është një analizë e anëve të forta “S” dhe të dobëta “W”, të vet komunës.



Bazuar në rezultatet e analizës, është e mundur të arrijmë në përfundim, nëse komuna ka përparësi apo epërsi dhe burime të mjaftueshme të brendshme për të realizuar mundësitë në dispozicion, dhe për t’iu ikur rreziqeve eventuale të cilat mund të vijnë edhe nga faktorët e jashtëm, dhe cilat mangësi të brendshme kërkojnë eliminimin sa më të shpejtë të tyre.

Nëse analizojmë atë që theksuam më lartë, rrjedh se vlerësimi përmbledhës i gjendjes së Komunës së Kamenicës është bërë duke përdorur analizën SWOT, e cila shpalosë mjaft elemente të gjendjes aktuale në komunë, e që ndikohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, qoftë pozitiv apo negativ.

Faktorët e brendshëm pozitiv cilësohen si përparësi kurse ata negativ si dobësi. Ndërsa, faktorët e jashtëm cilësohen si mundësi të ofruara të cilat duhet shfrytëzuar, përkatësisht rreziqe, të cilat komuna duhet t’i ketë parasysh dhe t’iu shmanget.

Në vazhdim po prezantojmë të gjitha përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e dala nga analiza e mësipërme e vlerësimit të gjendjes aktuale në Komunën e Kamenicës. Renditja e tyre është bërë krahas informatave të nxjerra sipas rrjedhës së renditjes të pjesëve të analizuara.

### PËRPARËSITË

- Ka pozitë të mirë gjeografike
- Struktura e moshës së pulsisë e re
- Lidhje të mira të komunikacionit rrugor
- Transport relativisht i mirë
- Potencial i lartë për trashëgimi të pasur kulturore dhe arkeologjike
- Kushte të favorshme klimatike për zhvillim e të bujqësisë
- Tokë pjellore, livadhe e kullosa etj
- Ambient i përshtatshëm për biznese
- Shquhet për traditë shumëvjeçare të kultivimit të fidaneve
- Lehtësimet në regjistrimin e bizneseve të reja (shërbime të mira administrative)
- Infrastrukturë fizike, bazike, solide
- Burime të maftueshme të ujit të pijes
- Ambient i qetë dhe i sigurt
- Sistem i avansuar i arsimit

### MUNDËSITË

- Resurse të pashfrytzura minerale
- Natyrë e përsht. për turizem dhe rekreacion e sidomos turizmit malor dhe shëndetësor
- Promovimi i resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore
- Rritja e subvencioneve në zhvillimin e bujqësisë
- Zhvillimi i bujqësisë (diversifikimi i prodh. bujq.)
- Shfrytëzimi i fondeve të mundshme nga BE
- Aplikimi i lehtësirave administrative nga komuna për nxitjen e investimeve të huaja direkte
- Rritja e partneritetit publiko privat
- Promovimi i produkteve vendore dhe plasimi në tregun e jashtëm
- Mirëmbajtja e hapsirave të gjelbërta
- Zvoglimi ndërtimeve në toka pjellore

### DOBËSITË

- Migrimi kombëtar dhe ndërkombëtar
- Largësia nga qendrat e mëdha
- Shkallë e lartë e papunësisë
- Rrugë të pa kategorizuara, jo të mira
- Territori i madh dhe vështirësi për ta mbuluar me infrastrukturë fizike bazike
- Shumica e bizneseve aktive janë në sektorin e tregtisë apo në veprimtari jo prodhuese
- Buxheti i vogël i komunës
- Dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës
- Ndërtime në toka bujqësore
- Kapital i pamjaftueshëm për biznese
- Promovimi pamjaftueshëm i komunës te investitorët
- Qasje e pa mjaftueshme në fonde investive zhvillimore

### RREZIQET

- Migrimi kombëtar dhe ndërkombëtar
- Ndotja dhe degradimi i mjedisit (pyjeve, lumenjve)
- Zvoglimi i tokës bujqësore për shkak të ndërtimeve të egra
- Ekonomi jo formale
- Konkurrencë joreale, si pasojë e ekonomisë joformale
- Interesim jo i duhur i donatorve për investime
- Kredi jo të favorshme, interesat e larta të kredive
- Mos-mbulimi i të gjitha vendbanimeve me shërbime komunale (gjersia gjeografike)
- Rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve nëpër shkolla nga viti në vit i të gjitha niveleve
- Trajtimi jo i duhur i deponive për mbeturina dhe ujrave të zeza etj

## 4. QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Për të përmbushur misionin dhe arritjen e vizionit të komunës, qëllimet strategjike dhe objektivat specifike vendosen përmes proceseve të planifikimit strategjik.

Përcaktimi i qëllimeve strategjike paraqet hapin më të nevojshëm dhe më specifik drejt arritjes së vizionit, gjithnjë duke i marr në konsideratë çështjet e identifikuara, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet e mundshme aktuale të cilat janë në dispozicion, sepse çdo qëllim specifikohet me objektiva ose nën qëllime apo aktivitete, të cilat deshifrohen tutje nëpërmjet projekteve të detajuara për implementim.

Çështjet kryesore me të cilat përballlet Komuna e Kamenicës e që janë të fokusuar janë në pesë fusha, të cilat janë njëkohësisht qëllime strategjike për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Kamenicës Strategjia për zhvillim ekonomik lokal e komunës përfshin informata dhe sfida lidhur me fushat si më poshtë:

**Sfidat në sektorin e Arsimit:** Avansimi dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit, avansim të kapaciteteve në planifikim strategjik dhe monitorim, përmirësimi i cilësisë në menaxhim të arsimit dhe mësimdhënie, renovime apo pasije me inventar, investime në infrastrukturë aty ku nevojitet si dhe teknologji informative bashkëkohore. Sfidë është poashtu rënia e numrit të nxënësve, si dhe mbetja e stafit aktual në raport me numrin e nxënësve.

**Sfidat në sektorin e Infrastrukturës:** Përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve, investimi në infrastrukturë, trajtimi i ujërave të zeza, përmirësimi i ndriçimit publik, shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, si dhe caktimi i lokacioneve për deponimin e materialeve të ngurta.

**Sfidat në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:** Ruajtja e shëndetit publik, përmirësimi i shërbimeve shëndetsore, përmirësimi i infrastrukturës në shëndetësi, rritja e nivelit të kualifikimit të stafit, ruajtja e trendeve për furnizim me aparatura shëndetsore etj.

**Sfidat në sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë:** Krijimi i NVM, mungesa e njohurive adekuate për përpunimin e produkteve, mungesa e burimeve njerzore të kualifikuara, mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, parandalimi i ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore, shtimi i kapaciteteve për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore, mbrojtja dhe plasmani i produkteve bujqësore, përmirësimi i teknologjisë të përdorur nga bujqit, kapitali i pamjaftueshëm financiar, qasje të pamjaftueshme në fonde zhvillimore etj.

**Sfidat në sektorin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore:** Përmirësimi i infrastukturës së turizmit dhe rekreacionit përmes trashëgimisë kulturore, resurseve natyrore, peisazheve, ndërtimi i hapësirave të reja rekreative, kopshteve dhe lodrave për fëmijë, ruajtja e hapësirave të gjelbërta ekzistuese dhe shtimi sipërfaqeve të reja.

## Objektivi e përgjithshëm:1 ARSIMI

### 1.1 Objektivi specifik-Planifikimi profesional dhe menaxhimi në arsim

---

Projekti 1.1.1 Avansim i planifikimit dhe menaxhimit në arsim

Aktiviteti 1.1.1.1 Zgjedhja e drejtorëve të shkollave

Aktiviteti 1.1.1.2 Trajnim i drejtorëve për hartimin e planit zhvillimor të shkollës dhe menaxhimin në arsim

Projekti 1.1.2 Qendra për orientim në karrierë

Aktiviteti 1.1.2.1 Themelimi i qendrës për orientim në karrierë (2023-2024)

Aktiviteti 1.1.2.2 Bshkëpunimi me komunitetin e biznesit për identifikimin e nevojave dhe profilizimin e shkollës profesionale

### 1.2 Objektivi specifik-Avansimi i bashkëpunimit me komunitetin

---

Projekti 1.2.1 Bshkëpunimi me këshillin e prindërve

Aktiviteti 1.2.1.1 Përfundimi i procesit të themelimit të këshillave të shkollave dhe këshillit komunal të prindërve

Aktiviteti 1.2.1.2 Hartimi i kalendarit vjetor të takimeve

Aktiviteti 1.2.1.3 Raportet periodike për rezultatet në shkolla të komunës

Aktiviteti 1.2.1.4 Rritja e buxhetit të bursave për studentë

Projekti 1.2.2 Avansimi i komunikimit me komunitetin e prindërve

Aktiviteti 1.2.2.1 Zhvillimi i platformës digjitale për menaxhimin e sistemit arsimor komunal

### 1.3 Objektivi specifik –Edukimi në fëmijërinë e hershme

---

Projekti 1.3.1 Rritja e numrit të fëmijëve që vijnë në edukimin në fëmijërinë e hershme

Aktiviteti 1.3.1.1 Ndërtimi i çerdhes në fshatin Koretin

Aktiviteti 1.3.1.2 Ndërtimi i çerdhes në fshatin Roganë

Aktiviteti 1.3.1.3 Adaptimi i hapësirave tjera në çerdhet e komunës

Projekti 1.3.2 Avansimi cilësor i punës në Institucioneve prashkollore

Aktiviteti 1.3.2.1 Sigurimi i ushqimit të shëndetshëm

Aktiviteti 1.3.2.2 Shtimi i numrit të edukatoreve, motrave edukatore dhe stafit tjetër profesional psiko-pedagogjik

Aktiviteti 1.3.2.3 Trajtime për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve

## 1.4 Objektivi specifik-Infrastruktura fizike dhe mejdisi i punës

---

### Projekti 1.4.1 Renovimi i objekteve shkollore

- Aktiviteti 1.4.1.1 Renovimi i plotë i Gjimnazit "Ismail Qemajli"
- Aktiviteti 1.4.1.2 Renovimi i plotë i ShFMU "Metush Krasniqi"
- Aktiviteti 1.4.1.3 Renovimi i pjesëshëm i hapsirave në ShFMU "Abdullah Krashnica", ShFMU "Hasan Prishtina", ShFMU "Xhavit Ahmeti", ShFMU "Dëshmorët e Kombit" dhe ShFMU "Sadri Misini"
- Aktiviteti 1.4.1.4 Renovimi IP "Filizat" në Kamenicë
- Aktiviteti 1.4.1.5 Furnizimi me inventar dhe renovimi toaleteve në shkolla
- Aktiviteti 4.4.1.6 Regullimi i pjerrinave

### Projekti 1.4.2 Ndërtimi i objektit të ri të ShFMU "Fan S Noli" në Kamenicë

- Aktiviteti 1.4.2.1 Mbikqyrja e realizimit të projektit

### Projekti 1.4.3 Pajisje me teknologji digjitale dhe mjete tjera didaktike

- Aktiviteti 1.4.3.1 Pajisje e të gjitha klasëve me Smart TV
- Aktiviteti 1.4.3.2 Pajisje e të gjitha klasëve me Llap top
- Aktiviteti 1.4.3.3 Furnizimi i shkollave me mjete didaktike të punës dhe rekuizita sportive

## 1.5 Objektivi specifik-Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

---

### Projekti 1.5.1 Identifikimi i nevojave

- Aktiviteti 1.5.1.1 Bashkëpunimi me drejtorët e shkollave
- Aktiviteti 1.5.1.2 Bashkëpunimi me aktivet profesionale të shkollave
- Aktiviteti 1.5.1.3 Hartimi i planit për zhvillim profesional të mësimdhënësve

## Objektivi i përgjithshëm:2 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK

### 2.1 Objektivi specifik -Tërheqja e investimeve

---

- Projekti 2.1.1 Krijimi kushteve infrastrukturore
  - Aktiviteti 2.1.1.1 Dhënia e tokës në shfrytëzim në bashkëpunim me nivelin qendror
  - Aktiviteti 2.1.1.2 Orientimi i investimeve të sektorit privat në sektorin e përpunimit
  - Aktiviteti 2.1.1.3 Organizimi i takimeve dhe konferencave në mes bizneseve vendore dhe atyre të disasporës, për mundësinë e investimeve të përbashkëta
  - Aktiviteti 1.1.1.4 Promovimi i potencialit të Kamenicës përmes platformave të ndryshme

### 2.2 Objektivi specifik-Krijimi dhe mbështetja e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme

---

- Projekti 2.2.1 Rritja e fondit të subvencioneve dhe granteve
  - Aktiviteti 2.2.1.1 Krijimi i bizneseve të reja dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese përmes mbështetjes me subvencione dhe grante
  - Aktiviteti 2.2.1.2 Mbështetja e grave në biznes përmes trajnimeve profesionale dhe granteve
  - Aktiviteti 2.2.1.3 Ofrimi trajnimeve në fusha specifike që ndikojnë në rritjen e bizneseve me donatorët potencial
  - Aktiviteti 2.2.1.4 Promovimi i produkteve vendore përmes panairove
  - Aktiviteti 2.2.1.5 Mbështetja e sektorit të IT përmes trajnimeve dhe finalizimi i hapsirave të parkut teknologjik

### 2.3 Objektivi specifik –Valorizimi hapsirave relievore, klimatike, hidrologjike për rritje dhe zhvillim të Eko –turizimit dhe turizmit shëndetësorë në Kamenicë

---

- Projekti 2.3.1 Eko Turizmi
  - Aktiviteti 2.3.1.1 Ndërtimi i bujtinave
  - Aktiviteti 2.3.1.2 Investimi në infrastrukturë në viset malore
  - Aktiviteti 2.3.1.3 Promovimi i atraksioneve turistike në rrjetet sociale dhe mediale

### 2.4 Objektivi specifik –Turizmi kulturor me synim promovimin e atraksioneve kulturore siç janë monumentet kulturore historike dhe religjioze, si dhe ngjarjet kulturore me tradita e zakone lokale

Projekti 2.4.1 Turizmi Kulturor

Aktiviteti 2.4.1.1 Identifikimi i objekteve të reja kulturore, fetare historike në territorin e Komunës së Kamenicës

Aktiviteti 2.4.1.2 Konservimi duke investuar në restaurime profesionale

Aktiviteti 2.4.1.3 Organizimi i festivaleve për kulturën lokale dhe traditat si festivale për ushqime, muzikë, art, histori etj.

## 2.5 Objektiv i specifik-Turizmi sportiv me një gamë të gjërë produktesh, me synim rritjen e të ardhurave dhe ndërtimin e imazhit të Komunës

---

---

Projekti 2.5.1 Aktivitetet sportive

Aktiviteti 2.5.1.1 Shenjëzimi i shtigjeve të ecjes në natyrë

Aktiviteti 2.5.1.2 Organizimi i garave me bicikleta, motocikleta, veturave

Aktiviteti 2.5.1.3 Ndërtimi i urave tibetiane në pellgjet e lumenjëve

Aktiviteti 2.5.1.4 Paragllajdzimi

## 2.6 Objektiv i specifik-Tokat bujqësore, prodhimtaria e drithrave dhe planifikimi

---

---

Projekti 2.6.1 Penda në Shipashnicë të Poshtme

Aktiviteti 2.6.1.1 Projekti ujitja e tokave bujqësore

Aktiviteti 2.6.1.2 Diversifikimi i prodhimeve bujqësore nga drithërat në perime

Aktiviteti 2.6.1.3 Trajnimi i fermerëve nga DBPZHR dhe MBPZHR

Aktiviteti 2.6.1.4 Subvencionimi i fermerëve nga MBPZHR për drithëra

Aktiviteti 2.6.1.5 Subvencionimi i fermerëve nga DBPZHR për farëra

## 2.7 Objektivi specifik-Inventarizimi i tokave bujqësore

---

---

### Projekti 2.7.1 Klasifikimi i tokave bujqësore

Aktiviteti 2.7.1.1 Marrja e mostrave të dheut, analiza, përbërsëit dhe vetitë

Aktiviteti 2.7.1.2 Krijimi i hartave digjitale të tokave, vetitë e tokave bujqësore

Aktiviteti 2.7.1.3 Orientimi i fermerëve në përzgjedhjen e mbjelljes së kulturave bujqësore

## 2.8 Objektivi specifik-Shtimi i sipërfaqeve me serra në perimtari

---

---

### Projekti 2.8.1 Rritja e sasisë së prodhimit

Aktiviteti 2.8.1.1 Ngritja e dhjetë serrave në vitin 2023

Aktiviteti 2.8.1.2 Furnizimi i tregut me prodhime të freskëta vendore dhe zvoglimi i importit

Aktiviteti 2.8.1.3 Subvencionimi i pemëtarisë nga MBPZHR

Aktiviteti 2.8.1.4 Trajnimi fermerëve dhe vizitë serrave jashtë komunës

## 2.9 Objektivi specifik-Sektori i blegtorisë-Planifikimi

---

---

### Projekti 2.9.1 Insiminimi artificial i lopëve qumështore

Aktiviteti 2.9.1.1 Përmirësimi racor

Aktiviteti 2.9.1.2 Rritja e fondit blegtoral nga 3,000 në 4,500 krerë në 5 vitet e ardhshme

Aktiviteti 2.9.1.3 Subvencionimi i lopëve qumështore nga MBPZHR

Aktiviteti 2.9.1.4 Subvencionimi i qumështit për rritje të cilsisë MBPZHR

Aktiviteti 2.9.1.5 Subvencionimi i qumështit për litër-sasi

Aktiviteti 2.9.1.6 Trajnimi i fermerëve blegtorë



## 2.10 Trajtimi i qenve endacak

---

---

### Projekti 2.10.1 Menaxhimi i qenëve endacak

Aktiviteti 2.10.1.1 Evidentimi, matrikulimi i qenëve endacakë

Aktiviteti 2.10.1.2 Kastrimi

Aktiviteti 2.10.1.3 Dehelmetizimi

Aktiviteti 2.10.1.4 Mbrojtja e shëndetit publik

## Objektivi Përgjithshëm: 3 SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

### Objektivi Specifik 3.1

Investimi në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve cilësore - shëndetësore, sociale dhe rezidenciale për të gjitha njësitë e DShMS-së.

---

---

#### Projekti 3.1.1 Shërbime cilësore – shëndetësore, sociale dhe rezidenciale

Aktiviteti 3.1.1.1 Renovimi i objekteve ekzistuese, rritja e kapaciteteve të tyre

Aktiviteti 3.1.1.2 Pajisja me mjete të sofistikuara dhe të teknologjisë inovative

#### Projekti 3.1.2. Mirëqenie për pensionistët

Aktiviteti 3.1.2.1. Sigurimi i barërave esenciale për pensionistët e komunës

Aktiviteti 3.1.2.2. Hartimi i listës së barërave nga profesionistët shëndetësor

### Objektivi Specifik 3.2

Strategjia e Kujdesit Parësor-Shëndetësor në nivel lokal

---

---

#### Projekti 3.2.1 Shërbime cilësore-shëndetësore sipas konceptit të mjekësisë familjare

Aktiviteti 3.2.1.1 Riorganizimi i orarit dhe shërbimeve shëndetësore

Aktiviteti 3.2.1.2 Realizimi i vizatave shtëpiake dhe ofrimi i shërbimeve në shtëpi

#### Projekti 3.2.2 Zhvillimi profesional për profesionistët shëndetësor

Aktiviteti 3.2.2.1 Trajnimi i vazhdueshëm i personelit shëndetësor

Aktiviteti 3.2.2.2. Shkollimi specialistik dhe profilizimi i profesionistëve shëndetësor

### Objektivi Specifik 3.3

#### Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale

---

##### Projekti 3.3.1. Sensibilizimi i popullatës

Aktiviteti 3.3.1.1. Realizimi i fushatave/kampanjave sensibilizuese në funksion të promovimit dhe parandalimit të sëmundjeve dhe problemeve të ndryshme të natyrave sociale

Aktiviteti 3.3.1.2. Shënimi i ditëve ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

##### Projekti 3.3 2. Shëndeti i popullatës dhe imunizimi

Aktiviteti 3.3.2.1 Realizimi i kontrollave sistematike të nxënësve në shkolla dhe kontrollat sistematike për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit

Aktiviteti 3.3.2.2 Realizimi i kalendarit të vaksinimit konform standardeve të OBSH-së

### Objektivi Specifik 3.4

#### Banimi Social

---

Projekti 3.4.1 Formimi i Grupit Punues Komunal për hartimin e programit tre-vjeçar për banim

Aktiviteti 3.4.1.1. Identifikimi i nevojave për banim social

Aktiviteti 3.4.1.2 Hartimi i programit 3 vjeçar për banim social

##### Projekti 3.4.2 Ofrimi i mundësisë së banimit social

Aktiviteti 3.4.2.1 Sigurimi i zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit

Aktiviteti 3.4.2.2 Paraqitja e kërkesave për financimin e investimeve të reja dhe subvencioneve në Ministri, deri në muajin Mars 2023-2025 pa kosto

Aktiviteti 3.4.2.3 Krijimi dhe administrimi i bazës së të dhënave për familjet që përfitojnë nga programet për banim.2023-2025 GPKHPB

## Objektivi Specifik 3.5

### Rregullimi i kushteve për të moshuar

Prjojekti 3.5.1 Rregullimi i qendrës për të moshuar

Aktiviteti 3.5.1.1 Sigurimi i zones së ndërtimit(ridestnimi i objektit egzistues)

Aktiviteti 3.5.1.2 Buxhetimi për sigurimin e funksionimit të qendrës

Projekti 3.5.2 Funksionalizimi i qendrës për të moshuar

Aktiviteti 3.5.2.1 Ofrimi I kushteve të përshtatshme për banim

Aktiviteti 3.5.2.3 Administrimi i kërkesave nga të moshuarit potencialë që vendosen në qendër

## Objektivi i përgjithshëm: 4 INFRASTRUKTURA

### 4.1 Objektivi specifik- Rregullimi i projekteve infrastrukturore në Kamenicë

---

---

Projekti 4.1.1 Asfaltimi i rrugëve lokale, rregullimi i trotuareve, ujësjellsit, urave, parqeve dhe kanalizimeve në Kamenicë

Aktiviteti 4.1.1.1 Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenices(Tab 4.2 Financimi i projekteve kapitale Komunale 2023-2025)

Aktiviteti 4.1.1.2 Ndërtimi i infrastruktures publike me marrëveshje bashkëfinancimi me ministritë e linjës 2023-2025

Aktiviteti 4.1.1.3 Ndërtimi i kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza nga segmentet Hogoshti, Strezoci dhe Karaçeva e Epërme 2023-2027

Aktiviteti 4.1.1.4 Fillimi i aktiviteteve dhe studimi për impiantin te Dheu i Bardhë

Aktiviteti 4.1.1.5 Koordinimi i aktiviteteve për realizimin e projektit të pendes ne Desivojcë

### 4.2 Objektivi specifik-Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme për menagjimin e mbeturinave

---

---

Projekti 4.2.1 Zgjerimi i rrejtit të mbeturinave

Aktiviteti 4.2.1.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluara dhe pjesërisht të mbuluara

Aktiviteti 4.2.1.2 Përpilimi i listave dhe rritja e mblueshmërisë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në 90% deri në Dhjetor 2024

Aktiviteti 4.2.1.3 Hartimi i planit ndërkomunal të integruar të mbeturinave

Aktiviteti 4.2.1.4 Zbatimi i PNIM(caktimi i lokacionit dhe stacioneve të transferit për mbeturinat e ngurta)

### 4.3 Objektivi specifik –Reduktimi i sasisë së mbeturinave

---

Projekti 4.3.1 Nxerrja e pakove stimuluese dhe ndërgjegjësimi

Aktiviteti 4.3.1.1 Pako stimuluese për biznese me zero amballazhim dhe zero mbeturina

Aktiviteti 4.3.1.2 Shpërndarja e komposterve për shtëpi rezidenciale dhe restaurante me zero mbeturina

### 4.4 Objektivi specifik- Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

---

Projekti 4.4.1 Avasnimi i sistemit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave komunale

Aktiviteti 4.4.1.1 Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale

Aktiviteti 4.4.1.2 Hapja e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit

Aktiviteti 4.4.1.3 Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi

Aktiviteti 4.4.1.4 Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor

Aktiviteti 4.4.1.5 Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave shtazore dhe thertoret

Projekti 4.4.2 Themelimi i ndërmarrjes publike komunale me fushëveprimtari të ndryshme

## Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Kamenicës përfshinë periudhën pesë (5) vjeçare 2023-2027. Kjo strategji do të ketë një plan zbatimi i cili përbëhet nga aktivitetet, afati i zbatimit, kostoja financiare, burimet e financimit, institucioni udhëheqës dhe institucioni mbështetës.

Pas fillimit të implementimit, strategjia do të monitorohet dhe do të rishikohet në baza vjetore, dhe do të hartohen raporte të rregullta nëse po arrihen objektivat dhe synimet e SZHEL.

Plani i veprimit parasheh që strategjia të financohet nga Grantet Qeveritare, të hyrat vetanake të komunës dhe donatorët potencial. Kosto e parashikar e implementimit dhe ndikimi buxhetor për 3 (tre) vitet e ardhshme do të jetë: 25,191,191.00 €

### Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor

Përmbledhje e kostove të Strategjisë	Vitet	2023-2025
	<b>Totali</b>	<b>25,190,191.00€</b>

## PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SZHEL 2023-2027

### OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM: 1 ARSIMI

Objektivi specifik 1.1	Aktiviteti i projektit	Afati i zbatimit	Kostoja Totale/1vit(€)	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqes	Institucioni mbështetës
PLANIFIKIMI PROFESIONAL DHE MENAXHIMI NË ARSIM	1.1.1 Avancimi i planifikimit dhe menaxhimit në Arsim	2023-2027	PKF*	-	DKA	KOMUNA
	1.1.1.1 Zgjedhja e drejtorëve të shkollave		PKF	-	DKA	KOMUNA/MASHTI
	1.1.1.2 Trajnim i drejtorëve për hartimin e planit zhvillimor të shkollës dhe menaxhimin në arsim	2023-2024	5,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA/MASHTI
	1.1.2 Qendra për orientim në karrierë	2023-2024	PKF	-	DKA	KOMUNA
	1.1.2.1 Themelimi i qendrës për orientim në karrierë	2023.2024	13,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA
	1.1.2.2 Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit për identifikimin e nevojave dhe profilizimin e shkollës profesionale	2023-2026	PKF	-	DKA/KOMUNITETI	KOMUNA/KOMUNITETI I BIZNESIT
Objektivi specifik 1.2	Aktiviteti i projektit	Afati i zbatimit	Kostoja Totale/1vit(€)	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqes	Institucioni mbështetës
AVANSIMI I BASHKËPUNIMIT ME KOMUNITETIN	1.2.1 Bashkëpunimi me këshillin komunal të prindërve	2023-2027	PKF	-	DKA/PRINDËRIT	KOMUNA
	1.2.1.1 Përfundimi i procesit të themelimit të këshillave të shkollës dhe këshillit komunal të prindërve	2023	PKF	-	DKA	PRINDËRIT/KOMUNA
	1.2.1.2 Hartimi i kalendarit vjetor të takimeve	2023-2027	PKF	-	DKA/SHKOLLAT	KOMUNA

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027**

	1.2.1.3 Raportet periodike për rezultatet në shkolla të komunës	1023-2027	PKF	-	DKA/SHKOLLAT	KOMUNA
	1.2.1.4 Rritja e buxhetit të bursave për studentë	2024-2027	50,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA/DKA
	1.2.1.5 Zhvillimi i platformes digjitale për menaxhimin e sitemit arsimor komunal	2023-2024	20,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA/DKA
<b>Objektivi specifik 1.3</b>	<b>Aktiviteti i projektit</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja Totale/1vit(€)</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Institucioni udhëheqes</b>	<b>Institucioni mbështetës</b>
EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	1.3.1 Rritja e numrit të fëmijëve që vijnë në edukimin në fëmijërinë e hershme	2023-2027	5,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA
	1.3.1.1 Ndërtimi i çerdhes në fshatin Koretin	2023-2024	650,000.00	MASHTI	KOMUNA	KOMUNA/MASHTI
	1.3.1.2 Nërtimi i çerdhes në fshatin Roganë	2024-2025	210,393.00	KOMUNA	KOMUNA	KOMUNA
	1.3.1.3 Adaptimi i hapsirave tjera në çerdhet e komunës	2023-2027	10,000.00	MASHTI	DKA	2023-2027KOMUNA/MASHTI
	1.3.2 Avansimi cilsor i punës në institucionet parashkollore	2023-2027	PKF	-	DKA	KOMUNA/MASHTI
	1.3.2.1 Sigurimi i ushqimit të shëndetshëm	2023-2025	60,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA
	1.3.2.2 Shtimi i numrit të edukatoreve, motrave edukatore dhe stafit tjetër profesional psiko-pedagogjik	2023-2024	120,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA
	1.3.2.3 Trajnime për zhvillimin profesional të mësimeve	2023-2025	10,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2023-2027**

<b>Objektivi specifik 1.4</b>	<b>Aktiviteti i projektit</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja Totale/1vit(€)</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Institucioni udhëheqes</b>	<b>Institucioni mbështetës</b>
INFRASTRUKTURA FIZIKE DHE MJEDISI I PUNËS	1.4.1 Renovimi i objekteve shkollore	2023-2024	100,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA/MASHTI
	1.4.1.1 Renovimi i plotë i Gjimnazit "Ismail Qemajli"	2023	490,000.00	MASHTI	DKA	KOMUNA/MASHTI
	1.4.1.2 Renovimi i ShFMU "Metush Krasniqi"	2023	846.000.00€	BE	DKA	KOMUNA/MINISRITË
	1.4.1.3 Renovimi i pjesshëm i hapsirave në ShFMU "Abdullah Krashnica" "Hasan Prishtina" Xhavit Aahmeti" "Sadri Misini" dhe "Dëshmorët e Kombit"	2025-2027	200,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA/MASHTI
	1.4.1.4 Renovimi i IP "Filizat" në Kamenicë	2023-2024	30,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA
	1.4.1.5 Furnizimi me inventar dhe renovimi i toaleteve në shkolla	2023-2027	400,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA/MASHTI/DONATORËT
	4.4.1.6 Rregullimi i pjerinave	2023-2025	15,000.00	KOMUNA	DKA	KOMUNA
	1..4.2 Ndërtimi i objektit të ri ShFMU "Fan Noli" në Kamenicë	2023-2025	2,100,000.00	MSH	KOMUNA	KOMUNA/MASHTI
	1.4.2.1 Mbikryrja dhe realizimi i projektit	2023-2025	PKF	-	KOMUNA	KOMUNA/MASHTI
